



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor
“Administrim dhe Politika Sociale”
i
Institucionit të Arsimit të Lartë
Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof.Assoc. Dr. Merita Xhumari

2. Dr. Anisa Subashi

Prill/2021

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

**Për Programin e studimit: Programi i studimit të ciklit të parë “Bachelor” në
“Administrim dhe Politika Sociale”**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Fan. S. Noli”, Korçë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Sociale
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Administrim dhe Politika Sociale”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASH Nr. 279, datë 04.07.2013
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UMASR Nr. 323, datë 05.06.2017
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	18 PAE/4 PAK
18	Numri i studentëve (3 vitet e fundit):	(57+61+58)=176
19	Komente / të tjera:	

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës

Programi i studimit "Administrim dhe Politika Sociale" është një program i ri në Universitetin Fan S. Noli, Korçë (UNIKO), i hapur për herë të parë në vitin akademik 2013-2014, me Urdhërin nr.279, datë 04.07.2013, bazuar në Vendimin e Këshillit të Akreditimit nr.498, datë 03.06.2013. Programi zbatohet nga njësia bazë Departamenti i Shkencave Sociale (DSHS), si pjesë e njësisë kryesore Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane (FSHNSHH).

UNIKO ofron programin e studimit në përputhje me misionin dhe fushën e veprimtarisë së tij dhe në përgjigje të nevojave të zhvillimit social- ekonomik lokal dhe/rajonal. Programi synon formimin akademik të studentëve, aftësimin e tyre profesional në lidhje me administrimin dhe politikat sociale, në përputhje me misionin e institucionit "për të përcjellë dije duke përgatitur jo vetëm studjues të përkushtuar, por edhe profesionistë të zotë" (faqe 5).

Plani mësimor i programit BA APS pothuajse nuk ka ndryshuar në tre vitet e fundit akademike, 2017-2018, 2018-2019, 2019-2020, me përjashtim të spostimeve semestrale të ndonjë lende, apo ndarjen e lendëve në module. (Shtojca 2.7.A). Si programi mësimor edhe programet e lëndëve respektojnë strukturën dhe kërkesat referuar legjislacionit në fuqi (Shtojca 2.8). Në syllabuset e lëndëve ka diferencime sa i takon kërkesave për frekuentim, sikurse edhe në pikëzimet që marrin komponentë të ndryshëm për vlerësimin përfundimtar të lëndës.

Stafi akademik i brendshëm i DSHS dominon mbi atë me kontratë në raportet 3:1 dhe i gjithë stafi ka kualitetet e kërkuara për të përmbushur realizimin e programit, si përsa i takon nivelit akademik PAE 12 Dr dhe vetëm 2 Msc, ashtu dhe fushës së studimit. DSHS për realizimin e programit BA APS bashkëpunon jo vetëm me departamentet e tjera të FSHNSHH, por edhe të UNIKO. Për realizimin e praktikave profesionale në vitin e tretë, DSHS bashkëpunon me gati 20 institucione publike dhe OSHC në rajonin e Korçës (Shtojca 3.5), të cilat kanë krijuar mundësi edhe për punësimin e të diplomuarve nga ky program.

UNIKO ka të institucionalizuara të gjitha procedurat dhe kriteret përmes një sërë rregulloresh ku çdo element specifikohet me detaje. Mjediset janë të pajisura me logjistikën e duhur për realizimin e programit të studimit. Biblioteka shtohet me propozimet për tekste të reja në fillim të çdo viti akademik, krahas bibliotekës online.

Studentët janë pjesëmarrës në të gjitha hallkat e procesit të realizimit të programit të studimit, që nga vlerësimet për përmirësimin e syllabuseve, të programit, të vlerësimit për stafin akademik dhe

pjesëmarrjes në projektet kërkimore dhe seminare shkencore. Studentët janë të mirëinformuar që në fillim të studimeve për të gjithë komponentët e programit dhe faqja zyrtare e UNIKO informacionet e nevojshme për programin e studimit dhe detyrimet e tyre akademike.

Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Akreditimi i programit të studimit Bachelor në "Administrim dhe Politika Sociale" ofruar nga Universiteti Fan S. Noli, Korçë (UNIKO) u realizua në zbatim të Ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe Manualit "Për procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit".

Procesi filloi me njohjen e gjithë dokumentacionit të dorëzuar në platformën online të ASCAL, në sistemin AMS. Raporti i vlerësimit të brendshëm shërbeu gjithashtu si dokument orientues, i cili specifikonte me detaje gjithë dokumentet e tjera si Statusi i UNIKO, Plani Strategjik, studimi i tregut, Rregulloret për të gjitha aspektet e vlerësimit të programit të studimit BA APS, Manualët dhe Plani mësimor i programit të studimit me syllabuset e detajuara. Faqja online e Universitetit Fan S. Noli, Korçë, po ashtu, siguron informacione të mjaftueshme për t'u orientuar në aspektet kryesore të vlerësimit të këtij programi studimi.

Programi i studimit "Administrim dhe politika sociale" është çelur në vitin akademik 2013-2014 dhe nuk ka pasur vlerësime të mëparshme për t'u marrë në konsideratë sugjerimet e tyre. Në vitin 2017 është realizuar akreditimi institucional i UNIKO, që ka mundësuar përgatitjen edhe për vlerësimin në vijim të programeve të studimit, përfshirë edhe programin BA APS.

Në kushtet e pandemisë së COVID19 dhe zhvillimit të mësimin online në të gjitha IAL në vendin tone nga Marsi 2020, ASCAL propozoi për realizimin e procesit të akreditimit online. Përmes platformës Zoom u realizua vizita dy ditore në Universitetin Fan S. Noli, Korçë me datat 28-29 Janar, 2021 sipas agjendës bashkëngjitur.

Bazuar në procedurat standarde, ASCAL caktoi si ekspertë të jashtëm për vlerësimin e këtij programi Prof. Assoc. Dr. Merita Xhumari dhe Dr. Anisa Subashi. Gjatë gjithë procedurës, ekspertët u asistuan nga specialistët e ASCAL Muhamed Prezja dhe Aviola Bardhi.

Më datë 15.04.2021, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 2/22 prot, datë 15.04.2021, dërgohet në Institucion Draft- Raporti i vlerësimit të jashtëm. IAL përcolli komentet përmes AMS më datë 22.04.2021 dhe me shkresë zyrtare Nr 654/2 Prot, datë 22.04.20, protokolluar në ASCAL me Nr 2/23 Prot, datë 26.04.2021.

GVJ pasi u njohën me komentet e institucionit mbi Draft- Raportin sqaron si vijon:

GVJ shpreh konsideratë për GVB të UNIKO që i kanë konsideruar të dobishme vlerësimet e standardeve për zhvillimin e programit të studimit Bachelor në Administrim dhe Politika Sociale. Veçanërisht kanë nxjerrë në pah pikat e dobëta që GVJ ka konstatuar dhe që do të dëshironte të kishte reflektime pozitive nga UNIKO.



Komentet në lidhje me Standardin 1.4, Kriterin 3:

UNIKO ka të drejtë që i takon Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të bëjë Kodifikimin Kombëtar sipas ISCED të programeve të studimeve në të gjitha IAL, prandaj kjo gjë është theksuar edhe në sugjerimin e GVJ në raport. Ndërkohë, evidentimi i faktit që degët e shkencave sociale nuk mund të zhvillohen brenda një Fakulteti të Shkencave të Natyrës, kjo duhet të reflektohet nga UNIKO, pa prituri që Ministria të shpallë Kodifikimin Kombëtar. Sepse ndryshime të tilla bëhen gradualisht dhe duan kohën e tyre që ne besojmë se padyshim do jenë në vemendjen e UNIKO. ***Prandaj standardin 1.4 nga vlerësimi “Përmbushet pjesërisht” zëvendësohet me “Përmbushet kryesisht”, ndërsa Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I “Përmbushet plotësisht”.***

Komentet në lidhje me Standardin II.3, Kriteri 4:

Sa i takon procesit të vlerësimit të dijeve, aftësive dhe kompetencave të studentëve që ndjekin programin e studimit Bachelor në Administrim dhe Politika Sociale, GVJ ka evidentuar rregulloret e UNIKO, madje e ka vlerësuar si një universitet me dokumentacion të detajuar për çdo komponent të mësimdhënies e mësimnxënies. Duke shkuar përtej rregulloreve formale, nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve të këtij programi rezultoi se kishte vlerësime në raportet 40 % për vlerësimin e vazhdueshëm të studentëve përgjatë gjithë semestrit, kundrejt 60 % të vlerësimit të provimit final; kjo në gjykimin tonë është më e racionale sesa vlerësimi 30% gjatë semestrit dhe 70 % në provimin final që përcaktohet në Rregullore, e cila ka nevojë të reflektojë ndryshimet ku kërkohet një qëndrim aktiv i studentëve në auditore përgjatë gjithë lëndës, që lidhet edhe me një frekuentim të rregulltë, sesa një vlerësim vetëm në fund në provimin final. Mbështesim propozimin që UNIKO të reflektojë ndryshimet në Rregullore dhe stafi akademik në një pjesë të syllabuseve.



GVJ i qëndron vlerësimit fillestar për përmbushjen e këtij standardi.



Në lidhje me Standardin IV.4, Kriteri 3:

Bibliotekën e UNIKO, GVJ gjatë shqyrtimit të teksteve bazë të përcaktuara në syllabuset e lëndëve karakterizuese të programit të studimit në fondin e Bibliotekës konstatoi se disa mungonin, ndërkohë që stafi akademik shpjegoi se çdo fillim viti Biblioteka pasurohet me tituj të rinj. Pra ky program ka disa vite që zbatohet dhe përgjatë gjithë kësaj kohe studentët nuk kanë mundësi të konsultojnë literaturat bazë në gjuhën shqipe të viteve të fundit që propozohen nga stafi akademik i brendshëm i këtij programi studimi. Pasurimi i bibliotekës në një universitet me një larmishmëri fushash studimi nuk ka fund ndonjëherë, por një tekst bazë për lëndët karakterizuese të çdo programi studimi duhet të gjendet në Bibliotekën e vetme të UNIKO dhe t'u vihet në dispozicion studentëve që nuk kanë mundësi ta blejnë.



GVJ i qëndron vlerësimit fillestar për përmbushjen e këtij standardi.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Administrim dhe Politika Sociale”



I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi I.1				
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit Bachelor në “Administrim dhe politika sociale” është në përputhje të plotë me interesat kombëtare dhe përcaktimet e legjislacionit shqiptar. Programi promovon njohjen e politikave sociale të bazuara në vlerat e drejtësisë sociale, shtetit të së drejtës, integritimit evropian dhe të përcaktuara në "Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015- 2020" e zgjatur deri më 2022.			
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Në vlerësimin tonë konfirmojmë se programi i studimit është në përputhje të plotë me vlerat akademike dhe kulturore të përcaktuara në Ligjin e Arsimit të Lartë. Programi promovon vlerat e demokracisë, lirisë dhe të menduarit kritik, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ndihmon në ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare shqiptare, si dhe në promovimin e kulturës dhe traditës shqiptare që ka në themel solidaritetin midis brezave, si parimi bazë i politikave sociale.			
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit është në përputhje me Statutin dhe me Planin Strategjik 2016-2020 të UNIKO, në të cilat theksohet se misioni i institucionit është “të përcjellë dije duke përgatitur jo vetëm studjues të përkushtuar, por edhe profesionistë të zotë” (faqe 5). Në vlerësimin e GVJ programi studimit Bachelor në “Administrim dhe politika sociale” dallon për specifikën e tij të ndërthurjes së teorisë me praktikën.			
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Programi i studimit është hartuar duke respektuar nevojat e tregut të punës lokal e rajonal ku nevojat sociale janë të mëdha dhe kapacitetet e institucioneve lokale/rajonale kanë kapacitete të kufizuara me specialistë të politikave sociale. Duke qenë në përputhje me prioritetet e zhvillimeve sociale dhe ekonomike të rajonit të Korçës e më gjerë, programi ndërthur njohuri të shkencave politike, juridike, administrative dhe të punës sociale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht






				X
--	--	--	--	---

Standardi I.2				
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	UNIKO ka përcaktuar qartësisht se programi është hartuar dhe ofruar në përputhje dhe në zbatim me Planin Strategjik të institucionit 2016-2020. Qëllimi i këtij Plani Strategjik është ta drejtojë zhvillimin e programit të studimit në “përvehtësimin e kompetencave specifike dhe saktësinë metodologjike...për të formuar një qytetar të përgjegjshëm në shërbim të shoqërisë” që u bë e qartë në takimet me drejtuesit e institucionit dhe të Departamentit ku program realizohet.			
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Statuti dhe Rregullorja e UNIKO përcaktojnë objektivat akademike e kërkimore, qëllimet, misionin mënyrën e përmbushjes së përgjegjësive dhe shërbejnë si bazë për programin e studimit. Sipas dokumenteve referuese prioritet akademik është përcaktuar synimi që UNIKO të veprojë si një institucion arsimor dhe kërkimor inovativ dhe me ndikim në komunitet, duke shërbyer vlerat themelore njerëzore përmes zhvillimit dhe dhënies së njohurive të përditësuara me zhvillimet sociale, për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së jetës së komunitetit. Kjo është në përputhje me përcaktimet në Ligjin 80/2015 të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.			
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.	Programi studimit Bachelor në “Administrim dhe politika sociale” (BA APS), emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja është në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të institucionit. Programi është vendosur në Departamentin e Shkencave Sociale dhe përmbajtja ofron njohuri dhe kompetenca në përputhje me Nivelin 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X






Standardi I.3	
Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Referuar dokumenteve të përgatitura nga UNIKO dhe të depozituara në platformën online të ASCAL, në sistemin AMS, dhe pas diskutimeve me stafin e UNIKO, GVJ vlerëson se Programi i studimit BA APS u mundëson studentëve të pajisen me aftësi për analizë kritike të njohurive në fushën e politikave sociale. Krahas njohurive, program i aftëson studentët mbi funksionimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, kompetencat ligjore dhe ekonomike, ato të komunikimit dhe ndërveprimit kulturor përmes organizimit të seminareve, projekteve shkencore dhe praktikave profesionale. Studentët aftësohen të jenë krijues dhe të angazhohen në praktika mësimore dhe institucionale në rajonin e Korçës.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Nga takimi me Qendrën e Karrierës dhe Alumnit (QKA) në UNIKO dhe Njësinë me Marrëdhëniet me Studentët, si dhe referuar statistikave rreth gjurmimit të studentëve për vitet 2016-2019 në linkun https://www.unkorce.edu.al/sq/qka-statistika GVJ vlerëson se studimet mbi tregun lokal të punës kryhen në mënyrë periodike. Staf i akademik i Departamentit të Shkencave Sociale (DSHS) mban marrëdhënie të vazhdueshme me institucionet shtetërore dhe private të shërbimeve sociale dhe OSHC në rajonin e Korçës, duke mundësuar praktikën e studentëve si dhe ndjekjen e studentëve që janë punësuar pranë tyre (Shtojca 2.10). Gjithashtu QKA është funksionale dhe aktive përmes këshillimit, informimit të vazhdueshëm, koordinimit dhe zhvillimit të pyetësorëve me studentët e diplomuar (Tabela për punësimin e studentëve të programit të studimit Administrim dhe Politika Sociale në Shtojcën nr. 4.6.)</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të nxënies, garantojnë përfundimin e</p>	<p>Referuar Rregullores së Programit të studimit BA në APS 2019-2020 (Shtojca 2.5.C) dhe bisedave me Përgjegjës të DSHS, GVJ gjykon se objektivat formues të programit si dhe të gjithë elementët e tij struktura, përmbajtja, metodika që përdor në dhënie të dijeve, vlerësimin e tyre, u mundësojnë studentëve</p>



dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.	plotësimin e një profili të lartë profesional në funksion të nevojave dhe kërkesave të tregut të punës në rajonin e Korçës e më gjerë. Programi realizon lidhjen e teorisë me praktikën profesionale pasi trajton çështje që kanë të bëjnë me njohuritë bashkëkohore dhe zhvillimin e aftësive profesionale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.4	
Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.	Bazuar në treguesit e deritanishëm, akreditimi i vazhdueshëm institucional dhe i programeve, si dhe në raportet vjetore të DSHS për vitet 2016-2019, (Shtojca nr. 3.8), vlerësojmë se institucioni ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e nevojshme në funksion edhe të programit Bachelor në APS. Departamenti i Shkencave Sociale përbëhet nga personel akademik i kualifikuar për të mbuluar modulet e programit BA APS, gjithashtu angazhon anëtarë të personelit akademik nga fakultete të tjera të Universitetit. Të dhëna mbi personelin akademik të Programit Bachelor në Administrimi dhe Politika Sociale gjenden në Shtojcën nr. 4.1.
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Studimet në Bachelor në APS janë në përputhje me fushën akademike të njësisë bazë, Departamenti i Shkencave Sociale, <i>por jo me fushën akademike të njësisë kryesore, Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane sipas klasifikimit ISCED.</i> Departamenti i Shkencave Sociale u shkëput nga Fakulteti i Mësuesisë me të drejtë, pasi edukimi është klasifikimi ISCED 1, kurse Shkencat Sociale janë Klasifikimi ISCED 3. Mesa duket, Urdhërit nr. 16, datë 17.01.2012 të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës që e vendos si njësi bazë pranë Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane, i takon një periudhe kur ky klasifikim nuk






	zbatohet nga Ministria jonë. <i>Është momenti që ky pozicionim i Departamentit të rishihet.</i>			
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Në vlerësimin e GVJ programi studimit ofrohet pranë Departamentit të Shkencave Sociale, ku fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, ku ne shkencat sociale përfshihen sociologjia, shkencat politike, psikologjia, shkencat ekonomike dhe ato të komunikimit. Programi i studimit Ba APS ofron njohuri në të gjitha keto fusha specifike <i>Problemi qendron që Departamenti i Shkencave Sociale nuk mund të jetë i vendosur në Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane, që nuk janë të së njëjtës fushë studimi referuar klasifikimit ISCED: Shkencat Sociale janë në kategorinë 3, Shkencat Humane në kategorinë 2 dhe Shkencat e Natyrës në kategorinë 5. Pra edhe Fakulteti duhet të ndahet në Shkenca të Natyrës dhe Shkenca Humane si dy fusha studimi që kanë klasifikime të ndryshme sipas ISCED.</i> Është përgjegjësi e Ministrisë së Arsimit të rishikojë organizimin e programeve sipas klasifikimit ISCED në të gjitha IAL. Kodifikimi kombëtar i programeve të studimit, siç parashikohet nga dispozitat e Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" Nenit 86, nuk është aprovuar ende nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. <i>Vlerësimi i këtij kriteri dhe Standardi ndryshon vlerësim, bazuar në komentet e përcjella nga IAL mbi draft- raportin.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	



Standardi I.5	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>UNIKO ushtron aktivitetin e tij në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi, konfirmuar nga akreditimi institucional. Dokumentet rregullatorë, si Statuti i Universitetit, Rregulloret e Fakultetit (Shtojca nr. 2.2) dhe të Departamentit (Shtojca nr. 2.3) përcaktojnë dhe sigurojnë marrëdhënie bashkëpunimi në institucion, duke ndarë detyrat dhe përgjegjësitë, analizën dhe vlerësimin e vazhdueshëm, si dhe sistemin e karrierës bazuar mbi meritat. Organet kryesore dhe personeli akademik kanë mbështetjen e plotë nga struktura administrative e institucionit dhe vlerësimi i punës bëhet rregullisht si nga përgjegjësi i Departamentit edhe nga burimet njerëzore.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Nga biseda me drejtuesit e UNIKO dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ gjykon se për realizimin e programit BA APS, Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me institucionet e qeverisjes vendore si Bashkinë Korçë, apo të tjera në qarkun e Korçës, si dhe institucionet publike të shërbimeve sociale. Krahas tyre, marrëveshjet shtrihen edhe me OSHC apo ofrues të shërbimeve sociale ku studentët e këtij programi mund të punësohen, pasi ata provojnë profesionalizmin e tyre gjatë zhvillimit të praktikës (internship) mësimore. (Lista e plotë e marrëveshjeve institucionale specifikohet në Shtojcën nr. 2.10).</p>
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Gjatë bisedës me stafin e DSHS, GVJ u informua se shkëmbimet e mendimeve e vlerësimeve mes pedagogëve të praktikës profesionale dhe mbikqyrësve të institucionit kanë sjellë përfitime në përmirësimin e programit të studimit duke iu përshtatur kërkesave të tregut (Raporti i përfitimeve në Shtojcën 3.6). Konkretisht raporti i datës 3.6.2020 për përfitimet nga marrëveshja me Kryqin e Kuq e realizuar që nga viti 2016 specifikon rritjen e njohurive të studentëve gjatë praktikës në lidhje me administrimin e politikave dhe shërbimeve sociale, njohje me legjislacionin aktual dhe aftësi për komunikim dhe kompetenca të administrimit publik.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të</p>	<p>Për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, UNIKO ka hartuar Udhëzuesin e praktikës institucionale (Shtojca nr. 3.24) i cili mbështetet në marrëdhëniet zyrtare të institucionit me bashkëpunëtorët e tij lokalë/rajonalë, gjithsej 20 subjekte (Shtojca 3.5). Studentët konfirmuan zhvillimin e praktikave profesionale</p>






natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	në institucione të ndryshme si në njësitë e qeverisjes vendore, në bashkinë e Korçës, zyrën e punës, agjencinë e sigurimeve shoqërore dhe në OSHC, ku kishte edhe studentë të punësuar.			
Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Departamenti mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar për organizimin e lidhjeve mes universitetit dhe institucioneve ku ata janë punësuar. Trajnimet i zhvillon Qendra e Edukimit të Vazhduar pranë UNIKO e cila ofron informacione ne linkun: https://www.unkorce.edu.al/sq/qendra-p%C3%ABr-formimin-e-vazhduar			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X






II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	GVJ vlerëson se kurrikula e programit të studimit BA në APS është e organizuar me lëndë dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Referuar planit mësimor të Programit të studimit Bachelor në APS, disipinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në këtë program studimi janë të organizuara në lëndë dhe module të specifikuar në 5 kategori nga A-E, në përputhje me VKM 41 datë 24.01.2018. Programi i studimit si çdo program Bachelori ka një kohëzgjatje prej tre vitesh akademike me 180 ECTS, të ndara në 60 ECTS për çdo vit akademik.
Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë e profesioneve specialitetesh.	Kurrikula e programit të studimit është ndërtuar në përputhje me Nivelin 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve bazuar në Ligjin nr. 10247, datë 04.03.2010 "Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve", të ndryshuar. Studentët në përfundim të studimeve të tyre në Bachelor fitojnë njohuri të thelluara profesionale mbi politikën sociale dhe administrimin e institucioneve sociale, por edhe njohuri juridike, mbi qeverisjen lokale, marrëdhëniet publike, ekonominë dhe psikologjinë duke u aftësuar njëkohësisht si specialist të administrimit dhe politikave sociale (Aneksi me Tabelën përmbledhëse).
Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	Programi i studimit BA APS ofron njohuri profesionale dhe aftësitë e kërkuara për të zhvilluar tek studentët mendimin kritik, referuar programit të lëndëve si: Analiza krahasuese e politikave sociale, Planifikimi social, Vlerësimi i programeve sociale, Politikat sociale të BE-së, teoritë e shtetit dhe të demokracisë, etj. Nga biseda me studentët ata ishin konfidentë për të vazhduar studimet edhe jashtë vendit, sikurse një pjesë e të diplomuarve të mëparshëm, apo pjesëmarrjes në programet Erasmus+. Edhe stafi






	akademik ishte aktiv në veprimtari ndërkombëtare për t'u njohur me publikimet më të fundit.
Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Programi duke qenë në nivel Bachelor nuk mund të ofrojë zgjidhje të problemeve komplekse dhe të paparashikueshme, por mund dhe ia ka arritur që në përputhje me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve të aftësojë studentët për mendim profesional, të menduarit kritik, për menaxhimin e aktiviteteve dhe projekteve, për trajtim teknik dhe profesional të çështjeve, si dhe të marrin përgjegjësi për të qenë pjesëmarrës në projekte të ndryshme. Në rregulloren e programit të studimit APS (Shtojca nr. 2.5) parashikohen orë praktike në terren në kuadrin e disa lëndëve të programit të studimit, si: Hyrje në administrim, Sociologji e punës, Organizimi i administrimit social, Administrim dhe drejtim i shërbimit social
Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	Në përmbushje të kërkesave ligjore, Programi i studimit BA APS përbëhet nga lëndë të organizuara si lëndë të Formimit Bazë (19%), të cilat synojnë pajisjen e studentëve me njohuri të përshtatshme teorike për shtetin social, teoritë e demokracisë dhe politikat sociale, ekonomike dhe shtetin e së drejtës dhe logjikën. Lëndët e Formimit Karakterizues synojnë sigurimin e një konteksti shkencor mbi administrimin social, politikat sociale dhe shërbimet sociale (53%). Lëndët ndërdisiplinore /integruese synojnë të aftësojnë studentët me njohuri teorike më specifike të shërbimeve sociale në sektorë të veçantë, ku përqindja është pak më e lartë sesa norma 15%. Lëndët plotësuese, synojnë pasurimin e sfondit të njohurive të studentit, të shprehive edhe vlerave në gjuhën e huaj, si dhe në praktikën institucionale. Provimi final ka 8 kredite që finalizon strukturën e programit të studimit.
Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Analiza e të dhënave mbi lëndët, ngarkesat përkatëse në kredite dhe kategoritë e përcaktuara në kurrikulën e programit tregon se ato janë gjithashtu në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse. Bazuar në VKM nr 41 datë 24.01.2018. Përcaktimi i moduleve është bërë në përputhje me veprimtarinë formuese dhe shënohet në sillabusin përkatës së bashku me kreditet e modulit. Kategorizimit e veprimtarive formuese jepen në Rregulloren e programit të studimit APS (Shtojca nr. 2.5. Harmonizimi i stafit akademik PAE





	i DSHS me Departamentet dhe fakultetet e tjera të UNIKO janë në përputhje me kërkesat ligjore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Sociale është pjesë e Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane, pasi u shkëput nga Fakulteti i Edukimit me Urdherin nr.16, date 17.01.2012. Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane përbëhet nga 4 njësi bazë (tre është kriteri ligjor): Departamenti i Matematikës, Departamenti i Informatikës dhe Fizikës, Departamenti i Infermierisë dhe DSHS, pavarësisht se midis tyre nuk ka fusha studimi të njëjta, por te klasifikuara sipas ISCED në 4 kategori të ndryshme. Ky Fakultet ka nevojë për ristrukturim, ndarjen e Shkencave të Natyrës me Departamentin e Matematikës dhe Departamentin e Fizikës, Shkencave Mjekësore me Departamentin e Infermierisë dhe Shkencave Humane me degën e Filozofisë. Ndërsa DSHS ka nevojë të përfshihet në Fakultet me programe studimi të Shkencave Sociale me Departament të Sociologjisë dhe Politikave Sociale.</p> <p>DSHS në zbatim të nenit 23, pikës 2, dhe nenit 25 të Ligjit nr. 80/2015, si dhe akteve nënligjore për akreditimin e programeve të studimit, ngriti Grupin e Vlerësimit të Brendshëm sipas të gjitha rregullave (Shtojca nr. 3.3) bazuar në Vendimin e Rektoratit nr. 282, datë 21.5.201944 për akreditimin e programit të studimit APS.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit</p>	<p>Vendimi nr. 283, datë 21.05.2019 i DShS cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit (Shtojca nr. 2.11), (Ka nevojë për saktësim në RVB nr. dhe data e Vendimit). Ajo që vihet re në këtë Vendim është se i njëjti coordinator (J.Jorgji) caktohet për të dy programet Bachelor, edhe për programin Bachelor</p>



<p>të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Filozofi -Sociologji, gjë që duhet ndarë ku çdo program studimi të ketë koordinatorin e vet. Përgjegjësitë e koordinatorit specifikohen në Rregulloren e Brendshme të DSHS, neni 14.</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>DSHS si njësia bazë përgjegjëse për ndjekjen e programit, i përmbush detyrimet që burojnë nga aktet ligjore, si dhe nga dokumentet statutare dhe rregulloret e institucionit. Në zbatim të nenit nr 25 pikës 4 dhe 5 të Ligjit 80/2015 si dhe Udhëzimit nr. 27 datë 29.12.2017 për “Strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë” pika 8, germa b., është ngritur Grupi Mësimor-Kërkimor (GMK): ‘Administrim dhe politika sociale’.</p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Nga verifikimi i të dhënave GVJ konstatoi se DSHS përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik. DSHS ka në përbërje 14 pedagogë, personel akademik efektiv me kohë të plotë, nga të cilët: 1 -Prof.Dr., 1 -Prof.Assoc., 9 Dr dhe 2 pedagogë Msc.(Aneksi, Tabela Përmbledhëse)</p>
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Analiza e Statutit të UNIKO, Rregullores së funksionimit të FSHSH dhe të DSHS, si dhe dokumenteve të tjera mbi të cilat zhvillohet aktiviteti i njësisë bazë/kryesore, tregojnë se ato i plotësojnë detyrimet ligjore. Personeli akademik efektiv me kohë të plotë ka nivel akademik të lartë për të drejtuar çdo modul të programit BA APS, 12 pedagogë PAE kanë gradën shkencore Doktor dhe vetëm dy janë me Msc(Aneksi me Tabelën Përmbledhëse në Tabelën e pare tregon një PAE prej 14 pedagogësh i cili mbetet i njëjtë për tre vitet e fundit akademike, 2017-2020, por qe nuk ka përputhje me tabelat ne vazhdim).Këto të dhëna janë në përputhje me nenin 25, pika 4, Ligji 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".</p>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3
Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	GVJ nga biseda me stafin akademik të Departamentit të Shkencave Sociale vlerëson se ai zotëron informacionet e duhura në lidhje me programin mësimor të BA në APS. Kjo u konfirmua jo vetëm nga biseda e GVJ me stafin akademik të Departamentit, por edhe nga takimet me studentët dhe njësitë e tjera mbështetëse të UNIKO. Të gjitha informacionet gjenden edhe në databazën e ASCAL si Rregullorja e programit të studimit APS (Shtojca 2.5), Plani mësimor i programit të studimit APS (Shtojca 2.7), etj.
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Refereuar Aneksit mbi Tabelat Përmbledhëse të Programi Bachelor në APS vlerësojmë se ai përmban 22 lëndë. Lëndët dhe ngarkesa përkatëse e tyre brenda kurrikulës janë në përputhje të plotë me dispozitat e Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 41, datë 24.01.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", i ndryshuar. Lëndët bazë (A) zenë rreth 20 % të krediteve, lëndët karakterizuese (B) të programit përbëjnë 53% të krediteve, lëndët nderdisiplinore (C) kanë një përqindje më të lartë se 12-15% e krediteve dhe sugjerimi është që lenda e metodave të kërkimit të ndërthuret me lëndën e logjikës e të kalojë në lëndët e formimit bazë (A) e të zhvillohet që në vitin e parë si logjika që t'i pajisi studentët me njohuri dhe aftësi për të kryer detyrat dhe projektet që do të zhvillojnë në lëndët e ndryshme përgjatë tre viteve dhe të aftësohen për punimin final të diplomës për studentët e shkëlqyer.
Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas	Programi i studimit BA APS është i organizuar në lëndë e module, të cilat janë të vlerësuara me kredite brenda e jashtë auditorit për arritjen e rezultateve sipas volumit të punës

sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	mësimore. Ato bazohen në natyrën e lëndës, si lëndë të formimit bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore-integruese dhe plotësuese. Në çdo vit akademik ka 60 kredite që në tre vitet e Bachelorit sigurojnë 180 ECTS.
Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	Programi BA APS është i detajuar në të dhënat që lidhen me planin mësimor, ngarkesën mësimore, orët, frekuentimin, ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve. Nga shqyrtimi i Planit Mësimor dhe syllabuseve jepen informacione në lidhje me ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe jashtë tij për çdo lëndë. Përsa i përket mënyrës së vlerësimit të dijeve i gjejmë të specifikuar në syllabuset e lëndëve. Kryesisht vlerësimi bazohet në një sërë indikatorësh përfshirë testet, ese, detyra, punë në grup, projekte dhe provimi final, që tregojnë metodat e larmishme të përdorura gjatë procesit mësimor. Në Aneksin e Tabelave Përmbledhëse, jepet në detaje syllabusi i lëndës “Shteti dhe Politikat Sociale” e cila i le 40 pikë vlerësimit gjatë semestrit dhe 60 pikë vlerësimit të provimit final. Ndërsa tabela më poshtë, faqe 15, specifikon 70 pikë për provimin final që GVJ gjykon se nuk është racionale për të siguruar vlerësimin në vazhdimësi përgjatë gjithë semestrit të studentit. Moduli Teoritë e Demokracisë në Shtojcën 2.8 Programet e Lendeve, ka specifikuar 70 pikë për provimin final.
Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Programi ka të gjithë informacionin e duhur adresuar studentëve mbi kriteret e përgjithshme, specifikat e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Rregullat e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve në programin e studimit Bachelor në APS janë të parashikuara në Rregulloren e UNIKO. Kjo u konfirmua edhe nga biseda me studentët që kanë realizuar mobilitetin nga UNIKO. Po ashtu, nga biseda me sekretarinë, GVJ konstatoi se ato pasqyronin saktë numrin e studentëve të pranuar, me të dhëna të plota referuar dosjeve të tyre.
Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën,	Programi Ba APS i përmban të gjitha informacionet e nevojshme të kërkuara në këtë kriter të cilat janë të specifikuar në shpallura e të aksesueshme edhe në faqen online të UNIKO. Syllabuset e lëndëve përmbajnë informacionet e nevojshme të detajuara në lidhje me objektivat e lëndës, tematikat e leksioneve dhe






seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	seminareve, orët brenda dhe jashtë auditorit, etj. Ato janë formalisht të unifikuara në përputhje me VKM 41, datë 24.01.2018. Gjithashtu syllabuset e lëndëve përcaktojnë strukturën e notës përfundimtare bazuar në totalin e vlerësimeve për testet paraprake, kolokiumet, esetë, detyrat, projektet dhe provimin final. Syllabuset kanë të njëjtin format dhe kanë të specifikuar literaturën e detyrueshme dhe atë suplementare (Shtojca 2.8, Programet lëndore).			
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	GVJ nga diskutimet me stafin akademik dhe drejtuesit e DSHP konstatoi praktikën së punës se në fund të çdo viti akademik bëhet rishikimi i programit të studimit, ndryshimet dhe përmirësimet e nevojshme - përfshirë ndryshimet e kurrikulave. Programi i studimit Bachelor në APS nuk ka bërë ndryshime në planin mësimor në vitet akademike 2017-2020 (referuar Aneksit 1, Tabelat Përmbledhëse, Tabela 11), vetëm ndonjë spostim semestral të lëndëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	



Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Programi BA në APS është strukturuar me 180 ECTS në total, çdo 1 ECTS përbëhet nga 25 orë ngarkesë, ngarkesa në auditor si dhe ngarkesa e nevojshme për studim individual, duke qenë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kjo ngarkesë ndahet në mënyrë proporcionale në 6 semestra dhe 3 vite akademike me 60 ECTS secili.
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë,	Programi BA APS përbëhet nga lëndë që adresojnë qëllimin e tij në formësimin e dijeve teorike e aftësive praktike dhe që janë në përputhje me fokusimin në tregun e punës të studentëve të diplomuar. Shpërndarja e lëndëve bazë, që ofrohen kryesisht

njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	gjatë vitit të parë dhe të dytë në këtë program studimi, vijon me lëndët karakterizuese të programit, specifike në vitin e dytë dhe të tretë të studimeve. Studentëve u kërkohet rregullisht që të përgatisin projekte, detyra dhe ese në të gjitha lëndët, që së bashku me praktikat profesionale në fund të vitit të tretë, përbëjnë një mundësi të aftësimi profesional.
Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësimi profesional.	Elementët përbërës të programit (lëndët, shpërndarja në semestra e vite, kreditet, etj), e mundësojnë arritjen e objektivave të tij. Semestri i parë fillon me hyrje në njohuritë në shkencat sociale, kryesisht në shkencat politike, sociologji dhe fushën e legjislacionit, të plotësuara këto me kursin e logjikës e cila ka nevojë të plotësohet me lëndën metodat e kërkimit ku duhet të ketë njohuri mbi shkrimin akademik. Pastaj në vitin e dytë futen lëndë karakterizuese të lidhura me politikat dhe administrimin social, analizat krahasuese të politikave sociale dhe atyre në BE. Në vitin e tretë, lenda e metodave të kërkimit që është përfshirë në kategorinë e lëndëve ndërdisiplinore, ka nevojë të ndryshohet edhe si kategorizim tek lëndët e formimit bazë, edhe si vit të kalohet në vitin e parë. Lëndët me zgjedhje mund të shtohen.
Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre është në përputhje me profilin e programit “Bachelor”, duke pasur si risi të tij fokusimin në politikat sociale krahasuese dhe ato evropiane. Raporti teori-praktikë është i balancuar me punën e pavarur jashtë auditorit të studentëve dhe praktikën mësimore. Gjithsesi formimi në 3 vite i lejon studentët të marrin konceptet dhe aftësitë e nevojshme profesionale.
Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Programi BA në APS ka ndërthurje pozitive midis veprimtarisë formuese dhe trajtimit të çështjeve konkrete të administrimit dhe politikës sociale. Ai mundëson arritjen e objektivave formues, për transferimin e studimeve, mobilitet, etj, konfirmuar edhe nga raste konkrete të studentëve që kanë vazhduar studimet në vendet e Evropës. Orët mësimore sipas planit mësimor (Tabelat Përmbledhëse), ndahen në orë mësimi në auditor (leksione /seminare) dhe orë studimi jashtë auditorit, si dhe 200 orë provimi i diplomës. Orët në total janë 4500 që i korrespondojnë 180 krediteve. Vemendja ndaj praktikës profesionale mundëson një






	lidhje midis teorisë dhe praktikës, si dhe punësim e studentëve në përfundim të studimeve, sikurse rezultojn nga përvojat e DSHS.
Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	Institucioni aplikon rishikimin dhe përditësimin e literaturës së lëndëve. Sipas shpjegimeve të stafit akademik të DSHS, në rastet kur mungon një tekst bazë i përditësuar, por edhe kur literatura bazë është e përditësuar, stafi akademik përdor si literaturë mbështetëse artikuj shkencorë të publikuar në 5 vitet e fundit në revista shkencore dhe të përkthyer nga pedagogu i lëndës.
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.	Programi i studimit garanton marrjen e njohurive, aftësive dhe kompetencave të synuara në nivelin bachelor. Referuar programit me lëndët respektive në çdo semestër, njohuritë vijnë duke u thelluar dhe zgjeruar nga një semestër në tjetrin, nga hyrjet në njohuritë në shkencat sociale, me teoritë e demokracisë deri te politikat e institucionet në BE dhe administrimi i shërbimeve sociale. Njohuritë përforcohen me zhvillimin e aftësive dhe kompetencave për vlerësimin dhe analizimin e politikave sociale, apo analizat krahasuese që mundësohen nga lëndë si logjika, metodat e kërkimit dhe gjuhëve të huaja (Shtojca 2.5).
Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Programi u jep studentëve njohuritë që mund të merren në një sistem Bachelor, i ndihmon ata për studime të avancuara, si dhe asiston ambiciet e studentëve për angazhime profesionale drejt tregut të punës. Stafi akademik dhe studentët sollën shembuj studentësh që kishin vazhduar studimet Master apo që ishin punësuar si në administratën publike lokale edhe në OSHC që ofrojnë shërbime sociale. Konkretisht DSHS ofron Master Profesional 'Administrim publik' me 60 kredite kurse Master Shkencor në Filozofi Sociale, një fushë e përafërt.
Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe	Përmes anketimeve me studentët e diplomuar, forumeve dhe diskutimeve me partnerët nga tregu i punës me të cilët ka marrëveshje institucionale, njësia bazë dhe institucioni konsultohen vazhdimisht me propozimet për nevojat dhe pritshmëritë e tregut të punës. Duke bërë rregullisht gjurmimet e studentëve të diplomuar dhe përmes marrëdhënieve të ngushta me një larmi subjektësh dhe aktorësh lokalë që janë të angazhuar në fushën e admin istrimit dhe politikave sociale, stafi akademik





partnerëve nga tregu i punës.	përshtat syllabuset dhe departamenti programin e studimit (Shtojca 3.12.B).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5	
Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Të dhënat për personelin akademik si dhe biseda me gjithë stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi si me kohë të plotë, ashtu dhe me kohë të pjesshme, konfirmojnë se ata përmbushin kërkesat ligjore të Ligjit 80/2015, Nenit 59, mbi kategoritë e personelit akademik. Referuar shpjegimeve në detaje të Tabelës Përmbledhëse, GVJ konstatoi se ka ngarkesa të mëdha përtej normave, madje në shumicën e rasteve mbi 200 % të normës. Një pjesë e pedagogëve PAE janë nga fakultetet e tjera brenda UNIKO, ndërsa PAK vjen ose nga Fakulteti i Shkencave Sociale të UT, ose nga institucione të administratës lokale. Ka një raport gati 3 PAE : 1 PAK që përmbush kriteret dhe tregon qartësisht se stafi akademik i brendshëm full time i Departamentit të Shkencave Sociale ka kapacitete të plota për realizimin e programit BA APS. Në vitin e fundit akademik 2019-2020 ka një prirje të rritjes së peshës specifike në numër të PAE (14 pedagogë) në raport me PAK (4 Pedagogë), ku dominojnë stafi lokal nga Korça. Sa i takon ngarkesës së lëndëve të programit mësimor, PAE ka një angazhimin mbi 80% të lëndëve dhe PAK ka mbulimin e lëndëve të programit në rreth 20%. Studentët ishin vlerësues për cilësitë e stafit akademik.
Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin	PAE dhe PAK në programin BA APS kanë grada shkencore shumë të larta, Msc ka vetëm për dy PAE. Po ashtu, diplomimi i stafit akademik përkon me fushën e studimit të programit BA APS mbështetur në të dhënat e stafit dhe kualifikimet, CV të përditësuara deri në Maj, 2020 sipas Shtojcës 2.9.A. Gjithashtu në lidhje me drejtimin dhe titullarët e fushave të studimit në këtë program studimi, angazhimi i personelit specifikohet në





në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	Rregulloren e DSHS (Shtojca 2.3). <i>Rishikimi i ngarkesave të PAE do të ishte një sugjerim për rritjen e cilësisë së mësimdhënies.</i>
Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	Niveli i kualifikimit të personelit akademik të programit të studimit BA në APS është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij dhe ka një përvojë pedagogjike relativisht të gjatë. Fusha akademike dhe ajo kërkimore e personelit akademik me kohë të plotë dhe atij me kohë të pjesshme që mbulon programin e studimit përkojnë me lëndët dhe kërkimet që ata zhvillojnë aktualisht (Shtojcës 2.9.A) (RVB ka vendosur Shtojcën 2.9.C?).
Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Në bazë të kurrikulës së programit të studimit BA në APS, studentëve iu ofrohet udhëheqje në përgatitjen e Praktikës Profesionale për diplomim (Shtojca 2.10). Një pjesë e këtij stafi ka patur përvoja pune në drejtimin e institucioneve lokale, si në Këshillin Bashkiak Korçë, në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore dhe në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, sikurs edhe specialist të këtyre institucioneve ftohen në mësimdhënie, si nga Drejtoria e Shëndetit Publik, Prokuroria, etj. (Tabela 6.3 tek Tabelat Përmbledhëse). Programi i studimit BA sipas legjislacionit në fuqi përfundon me provim diploma dhe vetëm në raste të studentëve të shkëlqyer me punim diplome. Studentët mund të realizojnë temën e diplomës sipas kriterit të përcaktuar nga DSHS me mesatare mbi 8.5 (Shtojca 2.5).
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve	Institucioni angazhon rregullisht asistentët, sipas programit mësimor dhe detyrimeve të përcaktuara në departament. Për vetë natyrën e këtij programi BA APS nuk ka nevojë për laboratorë, me përjashtim të atyre për gjuhët e huaja, pasi auditoret janë të pajisura me mjetet e nevojshme për zhvillimin e leksioneve dhe seminareve.


të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së Mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	Në databazën e ASCAL janë të shqyrtuar një seri Rregulloresh të hartuara dhe miratuara nga UNIKO në përputhje me Ligjin 80/2015 mbi bazën e të cilave GVJ gjykon se UNIKO mund të merret si model përkuadrin rregullator institucional. Në Rregulloren e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore-Shkencore (Shtojca 1.2) si dhe nga takimet me stafin akademik dhe studentët del qartë se institucioni ka politika të konsoliduara për përmirësimin e metodologjisë së mësimdhënies dhe të qasjeve inovative.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	Në nivelin e njësisë bazë, mësimdhënia dhe aftësitë inovative të personelit akademik vlerësohen rregullisht për të përmirësuar cilësinë nga Përgjegjësit e grupeve mësimore kërkimore, Përgjegjësi i Departamentit, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe studentët. Në kushtet e mësimit online për shkak të COVID19, stafi akademik i programit BA APS u trajnuar për përdorimin e shërbimeve që lidhen me mësimin online, sikurse u konfirmua gjatë bisedës me stafin akademik.
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Sipas praktikës së konsoliduar të institucionit çdo fund semestri studentët marrin pjesë në anketën e vlerësimit të çdo lënde përmes të cilës maten treguesit cilësorë dhe profesionalë të stafit akademik, të moduleve dhe të metodave të mësimdhënies. Studentët janë pjesëmarrës aktivë dhe e konsiderojnë këtë si një instrument konstruktiv ndërveprimi. UNIKO ka zhvilluar anketime online edhe gjatë periudhës së pandemisë COVID-19. Të gjitha këto u konfirmuan nga studentët dhe gjenden në Shtojcën 3.13.
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie	Rezultatet e vlerësimit përmes anketës dhe strukturave për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, përfshihen në raportet e analizës mësimore (Shtojca 3.8). Stafi akademik





bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	vihet në dijeni rast pas rasti dhe problematikat adresohen në departament.			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.	Institucioni bazuar në performancë mbështet stafin akademik në promovimin individual. Nga biseda me stafin akademik ai konfirmoi mbështetjen e institucionit për pjesëmarrje në veprimtari shkencore, si shkëmbime në kuadër të programeve Tempus dhe Erasmus+, etj. Nga ana tjetër, personeli akademik i ri është asistuar në mësim nga lektorë me përvojë, me qëllim transferimin e përvojës dhe garantimin e cilësisë së mësimdhënies. Referuar syllabuseve, shumica e lëndëve kanë dy pedagogë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Programi mësimor zhvillohet përmes një kombinimi të leksioneve, seminareve, detyrave të lëndës, projekteve dhe aktiviteteve të tjera, sikurse u konfirmua nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve, bisedave me stafin akademik dhe studentët. Leksionet e hapura, debatet publike me ekspertë të ftuar njohur të njohur, si dhe forumet profesionale dhe në nivel studentor janë pjesë e formave të mësimdhënies dhe transmetimit të dijeve. Institucioni ka një faqe interneti shumë të pasur në informacion dhe me akses të plotë në sistemin e brendshëm nga studentët dhe stafi akademik. Aneksi nr. 2.5.
Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të	Institucioni ndër vite ka dëshmuar aftësi të bashkëveprimit në diversitet kulturor të stafit akademik, duke krijuar një klimë pozitive dhe mbështetëse për krijimin e klimës së përshtatshme të diversitetit edhe tek studentët. Në vitin e dytë dhe të tretë të studimeve, krahas metodave klasike të mësimdhënies rritet kontakti i drejtpërdrejtë i studentëve me politikën sociale lokale dhe zbatimin e tyre në terren, nëpërmjet rritjes së forumeve e

<p>mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>debateve me personalitete lokale të ftuar dhe të praktikave mësimore dhe profesionale, si formatë tjera të mësimdhënies/mësimnxënies. Në funksion të harmonisë dhe diversitetit janë kryer vizita studimore në Kosovë dhe Greqi dhe programuar veprimtaritë jashtë-programore si konferenca ndërdisiplinore ndërkombëtare me Balkan Sociological Forum, sikurse u reflektua nga bisedat e GVJ me stafin akademik.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të nxënësve, objektivat formuese dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Institucioni ka programe dhe politika të qarta për stafin akademik, përfshirë mbështetjen për përmbushjen e detyrimeve për punimet e doktoraturave (vetëm dy pedagogë kanë mbetur me Msc), pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare, në vizita studimore. Fakulteti i Edukimit organizon trajnime mbi metodat e mësimdhënies që përfshijn mësimin ndërveprues, mjetet e reja të vlerësimit, burimet dixhitale dhe aplikacionet dhe burimet e tjera të krijuara për të ndihmuar studentët të arrijnë më shumë, veçanërisht në kushtet e mësimin online. UNIKO ka përpunuar Manualin e sistemit elektronik ESSE3, mbi procedurat mësimdhënëse në kushtet e digjitalizimit të mësimdhënies gjatë periudhës së pandemisë së COVID-19, ku mësimi në të gjithë programet e studimit u krye online përmes aplikacioneve Google Classroom, Google Meet, eduMEET, Moodle dhe Office 365.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Stafi vjen nga përvoja akademike në vende të ndryshme dhe me përvojë të gjatë profesionale, çfarë i mundëson atij të zotërojë njohuritë e nevojshme në funksion të jetësimit të programit. Përgjegjësi i departamentit organizon kontrole periodike të mësimin duke dhënë vlerësime të kompetencës së pedagogëve për lëndët që ofrojnë. Po ashtu, logjistika që pamë, kryesisht pajisja me projektor e pjesës më të madhe të klasave, ndihmon në shpjegimin qartë të koncepteve dhe njohurive për përcjelljen e dijeve tek studentët. Platforma Teams e mësimdhënies online në periudhën e pandemisë së COVID-19 njihet si një nga më të përdorurat në mjaft universitete që ka siguruar mundësi të mira si për pedagogët dhe për studentët në procesin mësimor.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke</p>	<p>Departamenti ka bërë përpjekje për të krijuar lidhje të qëndrueshme midis stafit akademik dhe moduleve/lëndëve kryesore. GVJ konstatoi se stafi ka një ngarkesë mbi dyfishin e normës (mbi 300 orë/vit shumica e PAE). Vlerësimi i formave dhe</p>





përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	metodikës së mësimdhënies realizohet përmes anketës së vlerësimit çdo fund semestri nga studentët, si dhe formës tradicionale të prezencës të autoritetit drejtues gjatë realizimit të leksionit/orës së mësimi, si dhe diskutimi i tyre për të ndërmarrë hapa përmirësues për të ardhmen. Mendimi i studentëve për përmirësime merr vëmendje dhe reflektohet, vlerësim që u konfirmua edhe nga takimi i GVJ me student			
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.	Përmes analizës së syllabuseve, pothuajse të gjitha lëndët në programin e studimit përfshijnë metoda interaktive dhe diskutim gjatë orëve të mësimi, ku vend të rëndësishëm në vlerësim i jepet prezantimeve në klasë, diskutimeve, projekteve ose analizave të studimeve të rasteve, si pjesë e vlerësimit të studentëve. Lëndët që kanë përcaktuar 30% të vlerësimit final të studentit nga aktivizimi në orët e seminareve duhet riparë për të respektuar standardin e UNIKO 40% vlerësimi gjatë seminareve dhe 60% provimi final. Biseda me studentët konfirmoi interesin e tyre për mësimin e realizuar përmes metodave interaktive.			
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Pjesë e metodave interactive sikurse doli gjatë bisedës me stafin akademik ka qenë dhe veprimtaria e Forumit të Debatit mbi Ditën e Evropës në 9 Maj, në kuadër të lëndës së semestrit të katërt në APS 'Politikat sociale të BE-së'. Studentët janë nxitur të bashkëveprojnë midis tyre dhe të aplikojnë për pjesëmarrje në sa më shumë praktika, trajnime, konferenca etj, për të nxitur tek ata ballafaqimin e njohurive të tyre me praktikën, pavarësinë në veprim e mendim krijues, si dhe konkurrencën pozitive në karrierë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Praktikisht Programi “Administrim dhe politika sociale” realizohet në godinën e Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane të UNIKO. Ambientet janë të rikonstruara dhe cilësore, konfirmuar edhe nga proceset e akreditimit të vazhdueshëm institucional dhe nga vizita në institucion. Sipërfaqja në dispozicion të zhvillimit të programit mësimor përllëgaritet në 2.27 m²/student. Pastërtia nuk diskutohet në një qytet me tradita si Korça, ndonëse universiteti në kushtet e veprimtarive të kufizuar në auditor për shkak të situatës COVID-19 zhvillon mësimin vetëm online. (Referuar takimeve online ne institucion)</p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Infrastruktura në dispozicion të mësimin është përshtatur në funksion të mësimdhënies dhe është plotësisht funksionale me auditorë të pajisur me videoprojektorë dhe me mjetet e nevojshme për realizimin e procesit mësimor. Mjediset ku zhvillohet mësimi kanë sistem funksional interneti. (Referuar takimeve online ne institucion)</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Prej kohësh në UNIKO ekziston një infrastrukturë e konsoliduar IT, i gjithë stafi akademik dhe studentët kanë të drejtë të përdorin vazhdimisht instrumentet e informimit dhe kërkimit të avancuar në sistemin online të universitetit, në netëorë-un e stafit akademik e studentor. Infrastruktura ofron korrespondencë elektronike, kërkim dhe shfrytëzim online të materialeve didaktike dhe shkencore, informim online të vlerësimit përfundimtar (ESSE3), komunikim online pedagog-student, etj. Pjesë e rëndësishme e infrastrukturës IT, është biblioteka online në dispozicion të pedagogëve dhe studentëve.(Referuar takimeve online ne institucion)</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Studentët njihen që në fillim të studimeve me lëndë dhe stafi akademik prezanton literaturën e detyrueshme dhe ndihmëse për lëndët respektive. Studentëve në mungesëtë teksteve bazë, pedagogët ju ofrojnë leksione të shtypura bazuar në artikuj e punime shkencore apo përkthime, etj. Nga biseda me studentët dhe bibliotekaren, GVJ krijoi bindjen se studentët shfrytëzojnë bibliotekën fizike të institucionit dhe atë online.</p>





<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Biblioteka e UNIKO duket se ka një kapacitet mesatar të botimeve, por për shkak të situatës së COVID19, vendin kryesor e zënë literaturat online me akses të hapur për studentët. GVJ konstatoi se në bibliotekë ka hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët, por ka pak prurje nga botimet e reja të viteve të fundit (në shqip) lidhur me politikat sociale. Orari i Bibliotekës nga dita e Hënë deri ditën e premte, në orët 08:00 - 16:00 ka nevojë të rishikohet sepse ajo nuk mund të funksionojë si administrata, por aksesi aty të jetë sipas nevojave të studentëve dhe stafit akademik, pse jo edhe më gjerë. (Referuar takimeve online ne institucion)</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>UNIKO zotëron një librari dixhitale e cila mundëson aksesimin online të një numri të konsiderueshëm të librave dhe revistave shkencore në fushën e Administrimit dhe Politikave Sociale, e aksesueshme nga të gjithë studentët dhe pedagogët. (Referuar takimeve online ne institucion)</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Në nivel institucional universiteti raportoi se ka gjithsej 86 kompjuterë nga të cilët 60 jane te vendosur ne dy salla laboratorike, ndersa ne bibliotekën e fakultetit ka 26 kompjutera, të cilat patëm rastin t'i shihnim gjatë vizitës online në mjediset e institucionit, të gjitha në dispozicion të studentëve, edhe atyre të programit Ba në APS.</p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Institucioni, përveç masave të zakonshme që mundësojnë platforma online të komunikimit, gjatë 2020 aplikoi masa të jashtëzakonshme për shkak të COVID-19. Nga GVJ u konstatua se programet e nevojshme për të shërbyer për mësimdhënie në programin e studimit BA APS përfshin sistemin e menaxhimit të mësimin përmes platformave të ndryshme dixhitale, si Google Classroom, Google Meet, etj., si dhe sistemin e librarise online që është një sistem i hapur për studentët dhe pedagogët. Pedagogët raportonin rregullisht për mbarvajtjen e mësimin online, numrin e studentëve të regjistruar, mënyrën e transmetimit të leksioneve dhe të vlerësimit të dijes.</p>





<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>Përmes sistemit interaktiv online paketës Office 365, e cila mundëson 4000 adresa elektronike, të cilat aktualisht janë të mjaftueshme për mbulimin e stafit akademik dhe studentëve që janë regjistruar duke përdorur email-in zyrtar të universitetit për komunikim dhe ndërveprim online në funksion të programit. Ai është një sistem modular i organizuar nga role dhe njësi përkatëse në universitet dhe informacioni ruhet në një bazë të dhënash të centralizuar.</p>			
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Sipas përgjegjësive të përcaktuara në rregulloren e departamentit dhe në funksion të cilësisë së mësimdhënies në program, stafi akademik asiston, mbështet, udhëzon dhe mbikqyr vazhdimisht rastet e përzgjedhjes, realizimit dhe mbrojtjes së diplomave nga studentët, nëse gjatë studimeve të tyre kanë arritur mesataren e notës 8.5. Vlen të theksohet se diploma Bachelor nuk kërkon mbrojtjen e një teme diplome, por të një provimi final, sipas ndryshimeve në Ligjin 80/2015, ndonëse UNIKO ka përcaktuar qartë rregullat për temën e diplomës (Vendimi i DSHS, dt. 31 Mars 2017).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Standardi III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p> <p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p> <p>Në përputhje me Udhëzimin nr. 27, dt. 29.12.2017, në nivel institucional, funksionojnë Drejtorja e Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor, në varësi të së cilës gjenden: Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë; Sektori i Projekteve KërkimorShkencor dhe Digjitalizimit. Gjithashtu, njëri nga zëvendësdekanët në FSHNH është përgjegjës për bashkërendimin me njësitë kryesore/bazë të aktiviteteve në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Pjesë e aktiviteteve janë edhe raportet periodike të vlerësimit të cilësisë, analiza e tyre, anketimet, etj.</p>

<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Sipas Statutit të UNIKO, Departamenti, si njësi bazë, është përgjegjës për mirëfunksionimin e programeve përkatëse të studimit, si dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë së programeve përkatëse të studimit. Departamenti e realizon këtë përmes konsultimeve me kurrikulat ndërkombëtare, favorizuar nga fakti që nje pjese e stafit akademik jane diplomuar ne universitetet evropiane dhe përvojave të sjella nga ta. Departamenti përmes aktiviteteve në auditor dhe jashtë tij, i favorizuar nga një numër i vogël i studentëve të regjistruar në programin e studimit BA APS, siguron një ndërveprim më të drejtpërdrejtë midis studentëve dhe pedagogëve dhe ndjekjen e ecurisë së tyre dhe vetëdijes për cilësinë e programeve të studimit që ofron.</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Departamenti dhe institucioni mbështesin format inovative të mësimdhënies duke nxitur përdorimin teknologjik, shkëmbimet profesionale, punën krijuese me projekte kërkimore, leksionet e hapura, bashkëveprimi me ekspertë, praktikant në institucione, etj. Platformat dixhitale kontribuon në realizimin e metodave të reja të mësimdhënies / mësimnxënies.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen jo vetëm me trajnime të vazhdueshme, përfshirje në projekte, vizita studimore, etj, por institucioni ka një politikë të qartë stimuluese mbështetëse për stafin akademik në punën e tyre si kërkues shkencorë, në pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare, si dhe programe të mobilitetit Erasmus.</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>UNIKO organizon trajnime të vazhdueshme kushtuar metodave të mesimdhënies dhe nevojave mësimore të personelit akademik, përmirësimin të aftësive mësimdhënëse dhe zbatimit të metodave bashkëkohore. UNIKO inkurajon zhvillimin e veprimtarive kërkimore që të përgatisë akademikë dhe ekspertë me njohuri të specializuara në fushat e tyre të interesit.</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë</p>	<p>Bazuar me Statut, Rregulloret dhe kontratat e punës, stafi akademik dhe ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve. Përmes sistemit të vlerësimit ata</p>

përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	angazhohen edhe për përmirësimin e mësimdhënies. Nga biseda me stafin akademik, të brendshëm e të jashtëm, GVJ konstatoi pasionin e tyre për të rritur cilësinë e mësimdhënies duke u njohur me aktivitetet e tyre shkencore. Kështu, në vitet 2012 dhe 2014 UNIKO ka organizuar dy konferenca shkencore mbarekombetare për didaktikën e shkencave sociale, të organizuar në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës, pedagogët e të cilit janë përfshirë si PAK në DSHS. Një pjesë tjetër e PAK, kryesisht specialistë të fushës, vijnë nga institucionet publike lokale duke sjellë metoda të reja në realizimin e mësimdhënies			
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Metodat e reja në mësimdhënie dhe efektiviteti i tyre janë objekt i analizave vjetore në DSSH sikurse rezultoi nga biseda me stafin akademik dhe drejtuesin e DSHS dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit respektiv (Shtojca 3.8). Efektet e metodave të reja testohen edhe përmes vlerësimeve që japin studentët në fund të semestrit për çdo lëndë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi III.5	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Rregulloret përcaktojnë qartësisht sistemin e vlerësimit, format e vlerësimit dhe të kontrollit të dijeve (Shtojca 1.2 dhe 2.5). Praktika e punës në institucion është konform detyrimeve ligjore lidhur me informimin e studentëve mbi metodologjinë e vlerësimit. Të gjithë studentët informohen në mënyrë të detajuar në orët orientuese. Aktet e UNIKO janë publike dhe gjenden online për studentët, të cilët vihen në dijeni që sapo nisin studimet Bachelor.
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e	Vetë përmbajtja e detajuar dhe e strukturuar e syllabuseve sipas standardeve përcaktojnë mënyrat dhe metodologjinë e testimit dhe të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore për studentët. Syllabuset respektojnë të njëjtin format

34

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al






vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	(Shtojca 2.8) dhe sikurse rezultoi nga biseda me stafin akademik ato prezantohen në fillim të cdo lënde/moduli nga titullari i saj. Takimi me studentët e konfirmoi një praktikë të tillë për tri vitet e studimit.			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Njohuritë e studentëve sipas lëndëve dhe specifikave të tyre vlerësohen duke u bazuar në vlerësimin për detyra, provim në mesin e sezonit, prezantime, projekte e provim përfundimtar dhe pjesëmarrje aktive në mesim. Në përfundim të lëndës, çdo pedagog njofton studentët për vlerësimin dhe sasinë e pikëve para hyrjes në provimin final. Informimi i studentëve për rezultatet përfundimtare kryhet nëpërmjet sistemit ESSE3 brenda 6 ditëve nga provimi përfundimtar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	Bazuar në analizën e detajuar të syllabuseve të këtij programi studimi, në bisedat me stafin akademik dhe studentët gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton që vlerësimi i përgatitjes shkencore dhe profesionale të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm gjatë gjithë vitit akademik. Në lëndë të ndryshme të këtij programi aplikohet testimi i njohurive përmes provimit të ndërmjetëm dhe atij përfundimtar, si dhe gjatë periudhës tjetër të vitit akademik ka kontrole të vazhdueshme të njohurive shkencore dhe aftësive profesionale që lidhen me prezantime, detyra kursi, etj, në varësi nga natyra e lëndës dhe përmbajtja e syllabusit të tyre.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të	GVJ u njoh nga drejtuesit e institucionit se ka venë në zbatim sistemin elektronik ESSE3 (Shtojca 1.6) ku hidhen vlerësimet nga pedagogu ku ruhen edhe për sezonet e tjera kur studenti është ngelës. UNIKO ka zbatuar edhe testimin dhe vlerësimin elektronik






ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	nëpërmjet sistemit CleanScore.Gjatë pandemisë së COVID19, mësimi i semestrit të dytë të vitit akademik 2019-2020 u zhvillua online dhe pedagogët proceduan me vlerësimin e vazhduar të studentit online në platformat elektronike në Google Classroom.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Programi dhe institucioni kanë një sistem vlerësimi të provimeve bashkëvepruese me studentët të përcaktuar qartë në Rregulloren e UNIKO (në Shtojcën 1.2), Rregulloren e FSHNH (në Shtojcën 2.2) dhe Rregulloren e programit të studimit APS. Komisionet e provimeve mbulohen nga lektori i lëndës dhe një staf akademik mbështetës në varësi nga natyra e lëndës.
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Institucioni ka siguruar anonimatin e fletëve të provimeve me shkrim përmes sekretimit nga sekretarja e departamentit.Nga semestri i dytë i vitit 2020, në kushtet e pandemisë së COVID19, provimet organizohen online nga pedagogu i lëndës dhe asistenti i tij/saj sipas sistemit elektronik ESSE3 me kodifikim për çdo student. Manuali i sistemit ESSE3 gjendet në Shtojcën nr. 1.6
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënësit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Përgjatë vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale, në varësi nga natyra e lëndës, pas çdo provimi stafi përgjegjës akademik jep komentet dhe sugjerimet lidhur me përmirësimet të ndryshme të procesit të të nxënësit nga studentit. Sistemi elektronik ESSE3 i jep mundësi pedagogut të jetë transparent në mënyrë që studentit të jetë më i qartë në vlerësimin që ka marrë, bashkëgjatur me notën e provimit, pedagogu bën komentet e tij/saj, për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. Manuali i sistemit ESSE3 gjendet në Shtojcën nr. 1.6
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk	Sipas akteve rregullatore të institucionit çdo rast i dyshuar kopjimi në provime trajtohet si shkelje e rregullave të cilat përcaktohen qartë edhe në Rregulloren e programit të studimit APS ku specifikohen procedurat e vlerësimit të studentëve, ku në rastet e kopjimit studentit konsiderohet mbetës.






tolerohen nga personeli akademik.	Rregulloren e FSHNH, neni 61, dhe neni 65, pika 7 & 8, në Shtojcën nr. 2.2.			
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Provimet dhe testimet me studentët bazohen në kontrollin e dijeve dhe rezultatet e tyre hidhen në sistemin elektronik ESSE3 brenda dy ditëve kur provimi është me gojë dhe brenda 6 ditëve kur provimi është me shkrim. Hedhja në sistem garanton transparencë dhe siguri, si dhe respekton të dhënat personale. Procedurat janë të parashikuara në aktet rregullatore të institucionit dhe të programit të studimit BA APS. Shtojca nr. 3.23.			
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Rezultatet e provimit hidhen në sistem nga komisioni i provimit ku studentet kane akses te plote. Pas shpalljes së rezultateve, studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi, ose të kundërshtojë rezultatin e marrë brenda dy ditëve. Sipas Rregullores së programit të studimit BA APS, studentët mund të apelojnë rezultatin e një provimi përfundimtar brenda 24 orëve pas kontestimit të rezultatit përmes kërkesës në Dekanat.			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Rregulloret e UNIKO, FSHSSH dhe të DSHS parashikojne aktet e verifikimit dhe vendimmarrjes pas ankesës së studentëve. Komisioni vlerësues i provimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë. Dekani pasi shqyrton kërkesën e studentit vendos, në bashkëpunim me përgjegjësin e Departamentit, që studentin nëse ka të drejtë, të rijapë provimin, me një komision me anëtarë të tjerë. Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës, si dhe vendimi i marrë regjistrohen në regjistrin e ankesave të studentëve që mbahet në dekanat.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi III.7	
Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të	Programi i studimit ofron njohuri dhe aftësi të përshkruara në detaje në syllabuset dhe dokumentacionit shoqërues të

<p>garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>programit si Plani Strategjik i FSHNSH (Shtojca 2.4.A) dhe Rregulloren e programit të studimit APS për tre vitet akademike të fundit (Shtojca 2.5.A, B, C). Referuar programit të studimit dhe diskutimeve me stafin akademik, GVJ vlerëson seky program zhvillohet në mënyrë të tillë që synon formimin e specialistëve në fushën e administrimit dhe politikave sociale duke garantuar rritjen e njohurive nga njëri semestër në tjetrin, nga viti i parë me njohuri hyrëse në këto fusha të cilat thellohen në vitin e dytë dhe të tretë. Studentët kanë mundësi të marrin njohuri të thelluara dhe njëkohësisht të zhvillojnë aftësinë profesionale, jo vetëm nga program BA APS, por edhe në varësi nga pasioni, angazhimi dhe angazhime të tjera plotësuese sikurse u reflektua nga studentët që aktualisht edhe punonin si vullnetarë apo me kohë të pjesshme në organizata që ofronin shërbime sociale në rajonin e Korcës.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Sipas të dhënave të programit, Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E) garanton zhvillimin e aftësive në fushën e teknologjisë së informacionit (Lende Plotësuese D) përmes 1 lende Informatike me 6 ECTS; lëndë e tipit “D” që në këtë program është lënda e gjuhëve të huaja Anglisht me 7 ECTS (Tabelat Përmbledhese, Tabela9). Krahas tyre studentët marrin edhe njohuri në fushën e Psikologjisë Sociale me 7 ECTS, të Sociologjisë Urbane me 5 ECTS si lëndë të tipit C. Gjithsesi studentët lëndën e Metodave Kërkimore që del si lëndë të tipit C e zhvillohet në vitin e tretë kanë nevojë ta zhvillojnë në fillim të studimeve me qëllim njohjen edhe përdorimin e metodave të kërkimit sasior e cilësor që ju kërkohet t’i demonstrojnë më pas në përgatitjen dhe prezantimin e detyrave/projekteve të kursit që duhet të mbrojnë në kuadër të zhvillimit të moduleve me karakter të mirëfilltë profesional në vitin e dytë dhe të tretë të studimeve. Në funksion të inkurajimit të diskutimit të ndërsjelltë midis studentëve dhe aftësimit për të punuar në grup, një rol luan edhe Praktika Institucionale me 7 ECTS, lëndë plotësuese e tipit D.</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo</p>	<p>Çdo anëtar i stafit akademik në fund të semestrit analizon edhe ecurinë e lëndës, rezultatet e arritura dhe parashikon ndërhyrje përmirësuese në varësi edhe nga rezultatet dhe sugjerimet e</p>






lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	studentëve, sikurse doli nga biseda e GVL me stafin akademik dhe pergjegjesin e DSHS. Në përfundim të lëndës/modulit studentët zhvillojnë një detyrë kurse sikurse paraqitet ne syllabusin e lendeve, në të cilën prezantojnë njohuritë e mara, si dhe kompetencat e fituara. Në përfundim të prezantimeve pedagogu analizon dhe vlerëson aftësitë dhe kompetencat e fituara (Shtojca 2.8).
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	Nga diskutimet me stafin akademik rezultoi se në përfundim të çdo moduli dhe semestri, stafi akademik informon studentët mbi gjetjet kryesore dhe vlerësimet e lëndës/modulit. Përmes kësaj forme pedagogu përmbledh dhe diskuton me studentët si të përmirësojnë marrjen e njohurive, metodologjinë e përdorur dhe aspekte të tjera të rëndësishme për kursin.
Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Sipas të dhënave të institucionit dhe nga takimi i GVJ me stafin akademik rezultoi se ai është vazhdimisht i angazhuar në aktivitete shkencore jashtë programit të studimit. I gjithë stafi ishte pjesë e projekteve e angazhimeve dytësore profesionale. Stafi akademik i kushton vëmendje realizimit të orëve të hapura, ku trajtohen dimensione të ndryshme dhe aktualitetit si barazia gjinore, apo të seminareve ku studentët e shkëlqyer të programit BA APS kanë qenë pjesë e prezantimeve dhe debateve (Shtojca e orëve të hapura, nr. 3.18).
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Për vetë natyrën e programit BA APS, lëndët e tij nuk kanë nevojë për laboratore, ndonese pedagogët përdorin teknologji gjatë mësimin. Në raste specifike, sidomos në detyra dhe ushtrime që lidhen me projektet, mund të përdoren edhe mjete të tjera mësimore. Programi ka praktiken profesionale që realizohet në semestrin e 6-të, dy ditë në javë, pranë institucioneve që FSHNH, që iu mundëson studentëve të zhvillojnë njohuritë e marra ne teori dhe te reflektojnë mbi to.
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Praktika e debatit dhe puna në grup nxitet edhe nga fakti se një pjesë e madhe e lëndëve trajtojnë tematika e çështje të përafërta dhe plotësuese me njëra tjetrën, për të cilat ka disa anëtarë të stafit akademik të kualifikuar. PAE dhe PAK qe vjen nga institucionet lokale diskutojnë edhe për zgjidhjen e problemeve më të rëndësishme sociale që ka rajoni i Korçës dhe më gjerë.





<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Stafi akademik dhe departamenti inkurajojnë studentët të zhvillojnë ide inovative në detyra të projektit, të avancojnë dhe promovojnë punimet e tyre shkencore në seminare dhe konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. Statusi i UNIKO garanton shprehjen e lirë të ideve dhe i siguron personelit dhe studentëve mundësi të barabarta për punë dhe studim.</p>			
<p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>Stafi akademik promovon përfshirjen e studenteve të BA APS në projektet e kërkimit shkencor që financohen nga donatorë të ndryshëm të cilat janë mundësuar nga statusi i pedagogut të UNIKO. Angazhimi në projekte të tilla mundëson kontakte për t'u njohur me ide dhe praktika të reja. UNIKO ka garantuar mbështetje financiare të studentëve me rezultate të shkëlqyera të programit të studimit APS, ndërsa disa të tjerë janë përjashtuar nga detyrimi i pagesës së tarifës së shkollimit.</p>			
<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Departamenti ka prioritet angazhimin profesional në netëorë dhe në programe shkëmbimi me universitete të tjera evropiane dhe të Ballkanit, në funksion të nxitjes së mobilitetit që deri tani ka qenë me teper për stafin akademik. Drejtuesit e Institucionit dhe stafi i DSHS ofruan të dhëna konkrete të shkëmbimeve të stafit akademik në universitetet e vendeve të BE dhe Maqedoninë e Veriut, duke besuar që edhe studentët e këtij program relativisht të ri të kenë mundësi në të ardhmen. Vetë studentët kishin pritshmëri të larta për të vazhduar programet Master jashtë vendit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.8 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit</p>	<p>Rregullat dhe procedurat për provimin përfundimtar ose mbrojtjen e diplomës janë publike dhe me akses online nga studentët dhe stafi akademik. Ato gjenden në Rregulloren e</p>

të studentëve dhe e bën atë publike.	UNIKO, Neni 108; Rregulloren e FSHNSHH, Neni 25; dhe në Rregulloren e DSHS, Neni 22. Shtojca 1.3
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Në funksion të asistimit të studentëve dhe transparencës koordinatori i programit të studimit në përfundim të semestrit të parë u shpërndan studentëve fondin e pyetjeve për provimin e formimit që ndërtohen në përputhje me kurrikulat mësimore të programit të studimit (Shtojca 3.25). Në rastin e diplomës, çdo pedagog që caktohet udheheqes i temes së diplomes punon me studentin e caktuar përkatësisht në mënyrë të pavarur duke u rekomanduar të gjitha materialet që mund të ndihmojnë studentin të kryejë punën e tij / saj të diplomës. DSHS vë në dispozicion të tyre manualin për përgatitjen e punimeve shkencore (Shtojca 2.15).
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Provimi final përmbledh njohuritë e tre viteve të studimit dhe kryesisht të lendeve karakterizuese të programit BA APS. Për secilin lëndë titullari i saj përzgjedh konceptet themelore që përfshihen në fondin e pyetjeve të provimit, nga të cilat Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final përzgjedh pyetjet që do të vendosen në tezen e provimit. (Shtojca 2.15).
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/diplomave.	Studentët, pasi njihen me fondin e pyetjeve dhe manualin e kërkimit shkencor, u ofrohet asistencë e gjerë nga stafi akademik për sqarimin dhe saktësimin e detajeve të programit, apo u ofrohen konsultime dhe ju vihen në dispozicion materiale shtesë në funksion të përgatitjes së tyre për provimin e formimit apo temen e diplomes. Tema e diplomës regjistrohet me një udheheqës shkencor që është caktuar pedagogu i fushës përkatëse dhe për formatet e kërkimit shkencor UNIKO ka përgatitur një Manual të detajuar që ju vjen në ndihmë studentëve (Shtojca 2.15).
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo	Në varësi nga natyra, tematika dhe rastet studimore, institucioni vendos infrastrukturën shkencore në dispozicion të studentit për të kryer matjet e nevojshme dhe për të arritur objektivat dhe fushën e studimit. Për të krijuar mundësi optimale për kryerjen e






jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	studimeve empirike, UNIKO i orienton studentet dhe mbikqyer punën e tyre në institucionet që ka marrëveshje bashkëpunimi (Shtojca 3.27).
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Bazuar në praktikën e konsoliduar akademike të institucionit, udhëheqësi i diplomës/tezës është përgjegjës për të asistuar dhe udhëhequr studentin gjatë gjithë fazës deri në mbrojtjen e saj. Studentët, të cilët në përfundim të semestrit të pestë plotësojnë kriterin e notës mesatare 8.5 (Shtojca 2.14) orientohen për mundësinë e punimit të një teme diplome në vend të provimit të diplomës. Studenti zgjedh në konsultim me pedagogun, që merr përsipër ta mbikqyrë, temën dhe hap pas hapi përcaktojnë të gjithë komponentet e punimit shkencor dhe procedurën sipas Manualit për Përgatitjen e Punimeve Shkencore të UNIKO (Shtojca 2.15). Në përfundim, udhëheqësi jep miratimin nëse studenti është i gatshëm të paraqesë temën para Komisionit të Diplomimit.
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Provimi i formimit mbrohet përpara një komisioni të përbërë nga 3 ose 5 anëtarë, që përfaqësojnë fushat kryesore të studimit të përcaktuara në fondin e pyetjeve të provimit. Sipas praktikës, studenti merr notën në përfundim të provimit final ose temës së diplomës. Nota është mesatarja e vlerësimit që ka dhënë çdo anëtar i Komisionit dhe procesverbalit firmoset nga të gjithë ata.
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Diplomimi i studentit përcaktohet në nenin 25 të Rregullores së Organizimit dhe veprimtarisë mesimore, kërkimore dhe shkencore të FSHNSHH. Modeli i diplomës dhe suplementit të saj për programin e studimit BA APS përcaktohet në Rregullore, sipas modelit të miratuar nga MASR (Shtojca 2.6).
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Sekretaria Mësimore ju ve në dispozicion studentëve sipas rregullave administrative në çdo rast që kërkohen prej tyre, kopjen e plotë zyrtare të programit të studimit edhe pas përfundimit të studimeve. Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun në UNIKO e disponon programin në dy gjuhë: shqip dhe anglisht.
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast	Bazuar në aktet ligjore dhe në dokumentet rregullatore të institucionit, Rregullores së Sekretarisë mësimore në UNIKO (Shtojca 1.10), regjistri i lëshimit të diplomave depozitohet në arkivat e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat. Sekretaria ruan kopjen e njëzuar me origjinalin për një kohë të pacaktuar.





pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA
PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>GVJ duke ju referuar dokumentacionit të paraqitur nga Institucioni dhe atij të marrë gjatë bisedës me UNIKO, konkludon se institucioni ka ngritur dhe ka funksionale strukturën përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programin e studimit “Administrim dhe politika sociale” e cila është Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit. Në Rregulloren e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit përcaktohen midis të tjerash llojin e dokumentacionit (në formë shkresore dhe/apo elektronike) që mbahet pranë institucionit dhe personin përgjegjës. Në lidhje me dokumentat që përmban dosja specifike e stafit akademik dhe administrative, institucioni vepron në bazë të udhëzimit për përmbajtjen e dosjes së stafit.</p> <p>Dokumenti nr. 5, Shtojca 1.4 Rregullorja e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit</p> <p>Dokumenti nr. 18, Shtojca 1.14 Udhëzimi për përmbajtjen e dosjes së stafit UK</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e dosjes së vetëvlerësimit, faqen eeb të universitetit dhe në informacionin e siguruar nga vizita online, GVJ konstatoi se procedurat e rekrutimit të personelit akademik janë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, statutin dhe rregulloren e rekrutimeve të UNIKO. Për më tepër institucioni ka miratuar dhe ka në fuqi dy dokumente: Udhëzimin për Rekrutimin e Stafit Akademik ku midis të tjerash specifikohen dhe kriteret e vlerësimit të kandidatëve, si dhe shtojcën 4.1.C mbi Kriteret për konkurim për pedagogë efektivë në DSHS, këtu vendosen kriteret më specifike për programin e studimit.</p> <p>Dokumenti nr. 17, Shtojca 1.13 Udhëzimi Rektorati për Rekrutimin e Stafit</p>






	Dokumenti nr. 75, Shtojca 4.1.C Kriteret për Konkurim për Pedagogë Efektivë në DSHS			
Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	Përditësimi i të dhënave kryhet çdo vit akademik dhe janë të hapura, me konkurs dhe synojnë përzgjedhjen e personave të kualifikuar që zoterojnë grada shkencore. Institucioni disponon udhëzime dhe dokumenta të hartuar që provojnë procedurat dhe kriteret për rekrutimin e personelit.			
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Kriteret e përgjithshme dhe specifike të rekrutimit të personelit akademik publikohen në faqen zyrtare ëeb të UNIKO (si edhe në rrjetet sociale të UNIKO) dhe janë në përputhje me kërkesat dhe specifikat të programit të studimit. Departamenti është ai që realizon kërkesen për pedagogë të jashtëm (me kontratë), të nevojshëm për realizimin e ngarkesës mësimore që më pas miratohet nga rektori.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Bazuar në informacionin e dosjes së vetëvlerësimit dhe informacionet e marra gjatë vizitës online, GVJ konstatoi se institucioni është i angazhuar në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm pune dhe me mundësi të barabarta për të gjithë personelin e angazhuar në programin e studimit “Administrim dhe politika sociale”

	<p>Dokumenti i vënë në dispozicion nga institucioni, tregon se stafi akademik në përgjithësi ka një ngarkesë mësimore që është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi , e cila është e përshtatshme dhe mund të realizohet prej tyre në mënyrë profesionale.</p> <p>Dokumenti nr. 76, Shtojca 4.2 Tabela e Ngarkesës së Stafit Akademik të Angazhuar në të Gjitha Programet e Studimit</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi angazhimin dhe mbështetjen e UNIKO për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik. Personelit akademik u ofrohej mundësia e publikimit pa kosto në revistën që boton UNIKO, pjesmarrja pa kosto në të gjitha konferencat që organizon vetë UNIKO.</p> <p>Ndërkohë, gjatë këtij takimi stafi akademik dëshmoi edhe për mbështetjen financiare të marrë për pjesëmarrje në konferenca shkencore jashtë institucionit kur ata i kishin bërë kërkesë këtij të fundit.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>GVJ konkludon se ka përpjekje dhe aktivitete të zhvilluara në funksion të kualifikimit dhe zhvillimit të stafit, trajnimit mbi metoda inovative dhe dëshmon për pjesëmarrje në aktivitete dhe konferenca të ndryshme. <i>Sugjerojmë që institucioni duhet të bëhet pjesë e projekteve kombëtare dhe veçanërisht ndërkombëtare (si psh Erasmus +) për këtë program studimi pasi si UNIKO ka të tilla.</i> Kjo do të ndikonte në rritjen e cilësisë së procesit të mësimdhënies. Praktika e institucioneve të ngjashme ndërkombëtare në fushën specifike të këtij programi, si dhe mundësitë për mobilitete në mësimdhënie dhe trajnime të stafit akademik do të ndikonte në kualifikimin e tyre të mëtejshëm.</p> <p>Dokumenti nr. 60, Shtojca 3.8.A Analiza vjetore e FSHNH</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>GVJ konkludon si nga dokumentacioni i dorëzuar ashtu dhe gjatë takimit se ka përpjekje maksimale nga institucioni për përmbushjen e objektivave të programit të studimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	






Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/ëve të studimit



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Godina në të cilën zhvillohen aktivitetet mësimore dhe të tjera, të këtij programi studimi është e pajisur me infrastrukturën e nevojshme për një realizim sa më profesional dhe eficient të detyrave nga personeli i angazhuar në këtë program. Dokumenti i vënë në dispozicion pasqyron të dhënat infrastrukturore në funksion të programit të studimit. GVJ konstatoi se programi i studimit “Administrim dhe politika sociale” i zhvillon aktivitetet mësimore në disa ambjente. Programi “Administrim dhe politika sociale” përmban module që i përkasin fakulteteve të ndryshme, ndaj dhe mësimi zhvillohet në disa godina të UNIKO-s. Ambjentet janë të pajisur me infrastrukturën e nevojshme për një mësimdhënie dhe mësimnxënie sa më cilësore. Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB si dhe në informacionin e marrë nga takimet online me stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmoi se mësimi zhvillohej gjatë ditëve të javës, në orarin 8.00-16.00. Studentët konfirmuan që leksionet dhe prezantimet e tjera zhvilloheshin duke përdorur edhe mjete audiovizive të cilat disponoheshin nga pedagogu i departamentit përkatës përgjegjës për mbulimin e lëndës. Dokumenti nr. 83, Shtojca 4.7 Të dhënat për infrastrukturën në funksion të programeve
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të	Gjatë vizitës online në institucion, GVJ konstatoi se në funksion të programit të studimit “Administrim dhe politika sociale” janë salla leksionesh, laboratorë dhe biblioteka. Sallat e leksioneve dhe seminareve janë në sipërfaqe optimale dhe bashkëkohore. Ato janë të pajisura me kompjuter dhe videoprojektor për të lehtësuar procesin mësimor. Në dokumentin Shtojca 4.7 Të dhënat për infrastrukturën në funksion të programeve pasqyrohen se në dispozicion të FSHNH janë 6 laboratorë. Ndërkohë konstatohet

metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	se të gjitha ambientet janë të pajisura me numër përkatës të lejeve higjieno sanitare ndërkohë nuk ka Akt Teknik për Mbrojtjen nga Zjarri.
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	FSHNH bashkëpunon me shumë me institucione rajonale të tilla janë: Prefektura Korçë, Bashkia Korçë, Bashkia Maliq, Bashkia Devoll, Bashkia Pogradec, Biblioteka Korçë, Prokuroria Korçë, Drejtoria Rajonale e Kulturës Korçë, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Korçë, Drejtoria Rajonale e Arkivave Korçë GVJ konkudon se institucioni disponon mjediset e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programit specifik.
Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga institucioni konkudojmë se FSHNH disponon 2 laboratorë të teknologjisë së informacionit; për këtë program studimi shërben një laborator kompjuterash me 20 vende pune aktive. Studentët mund të punojnë si në laborator, ashtu edhe në bibliotekë për realizimin e detyrave të kursit. Dokumenti nr. 60, Shtojca 3.8.A Analiza Vjetore e FSHNH
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	Praktikat mësimore realizohen në institucionet private ose publike me të cilët UNIKO ka marrëveshje. Në këtë kontekst janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me rreth 20 institucione të ndryshme përfshirë Prefektura Korçë, Bashkia Korçë, Bashkia Maliq, Bashkia Devoll, Bashkia Pogradec, Biblioteka Korçë, Prokuroria Korçë, Drejtoria Rajonale e Kulturës Korçë, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Korçë, Drejtoria Rajonale e Arkivave Korçë etj. Studentët mund të diskutojnë me tutorin e praktikave mësimore, apo pedagogë të tjerë të programit të studimit, për orët e praktikës. (260-orë në total- 100 orë për vitin e parë dhe 160 orë për vitin e dytë) janë të programuara që të zhvillohen në vendin e praktikës. Dokumenti nr. 45, Shtojca 2.10 Marrëveshje Bashkëpunimi në Mbështetje të Praktikave Institucionale Dokumenti nr. 37, Shtojca 2.5.C Rregullore e APS 2019-2020






Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Referuar dokumentacionit të dërguar nga institucioni dhe vizitës online, GVJ konstatoi se FSHNH vë në dispozicion të gjithë studentëve të regjistruar pranë këtij universiteti një sallë biblioteke me 22 vende leximi. Dokumenti nr. 83, Shtojca 4.7 Të dhënat për infrastrukturën në funksion të programeve
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe nga takimi online me përfaqësues të institucionit konkludojë se në dispozicion të bibliotekës së FSHNH gjënden fizikisht 10592 libra e revista për 22 vende. <i>Biblioteka nuk disponon literaturë fizike të nevojshme në mbështetje të këtij programi studimi si: tekste mësimore bazë në gjuhën shqipe; tekste mësimore dhe materiale ndihmëse në gjuhë të huaj; e cila mund të shfrytëzohet njëlloj nga të gjithë studentët e kolegjit.</i> Biblioteka ofron akses shfrytëzimi të barabartë për të gjithë studentët nga ora 8:00-16:00, nga e hëna në të premte. Dokumenti nr. 87, Shtojca 4.10 Të Dhënat për Fondin e Librave në Bibliotekë në Funksion të Programit të Studimit APS
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	<i>Institucioni nuk ofron akses në biblioteka on-line për studentët e këtij program studimi.</i> Ata mund të konsultojnë vetëm literaturë fizike në bibliotekë. Institucioni investon në shtimin e zërave në bibliotekë në varësi të kërkesave të pedagogëve të lëndës.



<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Nga vizita në këtë bibliotekë online rezultoi se ajo është e pajisur me pajisjet kompjuterike me qëllim kryesor aksesimin e shpejtë të bibliotekave online.</p> <p>Biblioteka është e pajisur me pajisje kompjuterike për të facilituar aksesin e studentëve.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit si dhe nga takimi online konkudon se ka përpjekje nga institucioni për shtimin e zërave të bibliotekës. Dokumenti Plan i Detajuar për Shtimin e Zërave të Bibliotekës parashikohet pasurimi i bibliotekës me të paktën 328 libra për FSHNH. Institucioni nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit që ka nënshkruar me një sërë institucionesh private dhe publike ndikon në formimin teorik, praktik dhe profesional të studentëve.</p> <p>Në këto institucione ku studentët realizojnë praktikën mësimore, shfrytëzojnë të gjithë burimet e tyre logjistike dhe jo vetëm, për të rritur praktikitetin e tyre.</p> <p>Gjithashtu, vecanërisht nga bashkëpunimi më bashkinë, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Korçë ju mundësohen trajnime, pjesëmarrje në seminare dhe ëorkshop-e, pjesëmarrje në panairt e punës, aksesin për mundësi punësimi, etj</p> <p>Dokument nr. 84, Shtojca 4.10.A Plan i detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës</p>			
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka ofron akses shfrytëzimi të barabartë për të gjithë studentët nga ora 8:00-16:00. Në sezona të veçanta në varësi të nevojave të studentëve biblioteka ofron dhe orarin e shërbimeve ekstra. Informimi i studentëve mbi oraret e funksionimit të bibliotekës bëhet dhe me anë të njoftimit në mjediset e institucionit. Zgjerimi i orareve të aksesit jo vetëm në sezona të veçanta por gjatë gjithë kohës, kjo në varësi dhe të kërkesave të stafit dhe studentëve, mund të ishte një lehtësi për studentët dhe stafin</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	



Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se UNIKO përdor si sistem të menaxhimit të brendshëm një sistem të quajtur ESSE3, sistem i cili është vënë në zbatim duke bashkëpunuar me RASH-in. Sistemi shërben për të gjeneruar një librezë elektronike ku pasqyrohen të gjitha të dhënat akademike të studentit. Sistemi mundëson menaxhimin e aktiviteteve të studentëve duke funksionuar si një sekretari elektronike.</p> <p>Gjatë takimeve me studentët ata u shprehën se e shohin sistemin mjaft praktik dhe funksional.</p> <p>Dokumenti nr. 9, Shtojca 1.6 .1 Rregullore ESSE3 Dokumenti nr. 8, Shtojca 1.6 Manuali i Sistemit Elektronik ESSE3</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemi i brendshëm i menaxhimit, ESSE3 administron informacione dhe dokumentacion për të gjithë të angazhuarit në këtë program studimi. Pedagogët e aksesojnë sistemin duke regjistruar hap pas hapi vlerësimet e studentëve. Sistemi shfaq siguri pasi veprimet janë të gjurmueshme.</p> <p>Sistemi shërben edhe për të ngarkuar elektronikisht regjistrat e pedagoqeve si dhe ngarkesën e tyre mësimore. Fizikisht regjistrat arkivohen në Departamentin e Shkencave Sociale.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi është lehtësisht i aksesueshëm nga studentët, stafi akademik dhe stafi administrativ; stafi administrativ luan një rol kyç në përditësimin dhe hedhjen e vazhdueshme të të dhënave. Stafi akademik gjithashtu ka akses të dedikuar për menxhimin e lëndëve të zhvilluara dhe komponentëve të vlerësimit total të studentëve.</p> <p>Sistemi ka të integruar edhe sistemin e pagesave bankare të tarifave të studimit si dhe të shërbimeve me pagesë të vendosura nga UNIKO. Sistemi është i mbrojtur nga ndërhyrjet dhe në këtë aspekt veprimet kryhen vetëm me akses të dedikuar.</p>


<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Nga takimi me studentët, GVJ konstanton që materialet për lëndët që zhvillohen në këtë program studimi ju dërgohen kryesisht përmes adresave të unifikuara të e-mailit. UNIKO ka kontraktuar edhe platformën Office 365, që ka rezultuar të jetë një praktikë e mirë për shumë institucione arsimore që e kanë përvetësuar atë. Por jo të gjithë studentet i përdorin.</p>			
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe komunikimit është shumë efektiv dhe në adresimin e problematikave të ndryshme të studentëve dhe pedagogëve gjithashtu. Një praktikë e mirë e UNIKO është edhe direktoria e ëeb “Kontaktto Rektorin”, ku mund të bëhen edhe raportime direkte tek hapsira e dedikuar e Rektorit.</p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentat e dorëzuara nga institucioni dhe nga kqyrja e faqes zyrtare ëeb të UNIKO, konkludon që informacioni që lidhet me këtë program studimi, programet e lëndëve, të dhënat rreth personelit akademik dhe aktivitete të ndryshme që zhvillohen publikohen në faqen e internetit të fakultetit http://172.16.0.2/sq/fakulteti-i-shkencave-natyrore-dhe-shkencave-humane në dy gjuhë, shqip dhe anglisht. Të gjithë elementët e mësipërm në terma të detajuar janë të publikuara në gjuhën shqipe, ndërsa në terma më të përgjithshëm janë publikuar në gjuhën angleze.</p> <p>Edhe në sistemin ESSE3, gjenerohen në formë të shkurtuar të gjitha silabuset e lëndëve të programit Administrim dhe Politika Sociale.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi IV.6


Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Njësitë përbërëse të UNIKO dhe departamenteve të tij, hartojnë projekt buxhetin duke u mbështetur në planin strategjik të zhvillimit të institucionit si dhe në nevojat e krijuara. Projekt buxheti ndjek të gjithë etapat e përcaktuara në rregullore dhe dispozita të veçanta, deri sa kalon tek Administratori për miratim.</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij</p>	<p>Buxheti miratohet për një vit në të gjithë Universitetin dhe burimet financiare specifikohen të shpërndahen sipas zërave, në departamentet dhe programet konkrete të studimit. Si çdo institucion publik, UNIKO, e mbështet veprimtarinë e tij duke respektuar ligjin e kontabilitetit dhe i nënshtrohet kontroleve apo auditimit financiar. Pasqyrat financiare dorëzohen çdo vit pranë MASR dhe Degës së Thesarit Tiranë. Dega e Auditit funksionon duke planifikuar plane të vazhdueshme auditimi për fushat e evidentuara si me risk të lartë, duke synuar përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe mësimdhënies.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare. Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi,</p>	<p>Raportet e veprimtarisë financiare, publikohen në programin e transparencës në faqen eeb të UNIKO. Program i transparencës mundëson një përfshirje më të gjerë të senatit akademik në vendimmarrje roli i Senatit Akademik është i një rëndësie të vecantë pasi është më pranë nevojave të zhvillimit të programeve të studimit. Institucioni ka miratuar dhe ka funksionale Rregulloren Financiare e cila parashikon të ardhurat e institucionit si dhe përdorimin e tyre si dhe strukturat përgjegjëse. Po ashtu dhe Rregulloren e Drejtorisë Së Financiare e cila përfshin detyrat që ndiqen nga drejtoria përkatëse. Institucioni ka aprovuar Praktikë të miratimit të buxhetit në të cilin detajohet programi buxhetor vjetor dhe afatmesëm për një periudhë 2 vjeçare 2021-2023.</p>



<p>institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p> <p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p>	<p>Dokumenti nr. 10, Shtojca 1.7 Rregullore e Drejtorisë Ekonomike</p> <p>Dokumenti nr. 11, Shtojca 1.8 Rregullore e Drejtorisë Financiare</p> <p>Dokumenti nr. 88, Shtojca 4.11.A Praktikë e miratimit të buxhetit të UNIKO</p>			
	Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	





V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentat e dorëzuar nga Universiteti Fan S. Noli verën se pranimi i kandidatëve të rinj për të ndjekur studimet bëhet në përputhje me kriteret e pranimit dhe të përzgjedhjes, të miratuara nga statuti i Universitetit, në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit 80/2015.</p> <p>Kriteret dhe procedurat janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. Ato janë të parashikuara në nenin 48 të rregullores së organizimit dhe veprimtarisë mësimore, kërkimore shkencore si dhe gjenden të publikuara në faqen elektronike të IAL.</p> <p>Kandidati duhet të ketë përfunduar Maturën shtetërore në vend ose e njëvlefshme me të. Diploma duhet të jetë e njohur nga struktura përkatëse e MASR dhe të plotësojë kriterin e meritës. Në nenin 26 në rregullore përcaktohet se pranimet e studentëve në Universitetin Fan S. Noli në të gjitha programet e studimit bëhen me vendim të Senatit Akademik, në përputhje me standardet shtetërore, të kapaciteteve akademike dhe infrastrukture.</p> <p>Dokumenti nr. 2, Shtojca 1.1 Statuti i Universitetit “Fan S. Noli” Dokumenti nr. 3, Shtojca 1.2 Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore dhe Kërkimore e UNIKO</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. Kjo gjë pasqyrohet edhe në Rregulloren e Universitetin Fan S. Noli në kapitullin 6, neni 58 dhe 60 procedurat dhe kriteret e pranimit në Ciklin e Parë të Studimeve. Aty përcaktohen rregulla të qarta, të barabarta dhe të njëjta që garantojnë të drejta identike për çdo student në këtë program studimi, që nga faza e regjistrimit në programin e studimit deri në përfundim të studimeve të tij.</p>

	Dokumenti nr. 3, Shtojca 1.2 Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore dhe Kërkimore e UNIKO
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	GVJ bazuar në dokumentat e dorëzuar nga institucioni vëren se Universiteti Fan S. Noli kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit bëhen publike përmes faqes ëeb të universiteti si dhe në rregulloren e këtij programi studimi gjithashtu dhe në përputhje me rregullat e vendosura nga ligjet dhe aktet nënligjore për arsimin e lartë, i dërgon në MASR. Po ashtu çdo person i interesuar mund të drejtohet dhe fizikisht pranë Sekretarisë Mësimore të Fakultetit dhe të Departamentit të Shkencave Sociale për të marrë të gjithë informacionet në mënyrë të detajuar.
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni, GVJ konkludon se institucioni ka një praktikë të miratimit të kriterëve të pranimit ku specifikohen lista e kriterëve për llogaritjen e pikëve të kandidatëve në programet e studimit të FSHNH. Po ashtu institucioni në përputhje dhe me ligjet në fuqi ka miratuar tabelën e pranimeve të reja për tre vitet e fundit (kuotat) specifikisht për programe të ndryshme studimi. Dokumenti nr. 61, Shtojca 3.9 Praktika e Miratimit të Kriterëve të Pranimit Dokumenti nr. 85, Shtojca 4.9 Tabela e Pranimeve të Reja për Tre Vitet e Fundit
Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	GVJ bazuar në dokumentat e dorëzuar nga institucioni sipas kreut VI të Rregullores së Universitetin Fan S. Noli, institucioni propozon mënyrën e pranimeve për studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme, neni 5 përcakton se Fakulteti miraton kriteret e pranimit të studentëve për secilin program studimi, bazuar në propozimet e njëjësive bazë, në përputhje me përcaktimet e ligjit dhe të akteve nënligjore në fuqi Komisioni i ekuivalentimit dhe vlerësimit, i ngritur pranë çdo departamenti, mbi bazën e dokumentacionit që dërgon IAL përkatëse, përcakton detyrimet që do të ketë studenti nëse pranohet në atë program, sipas planit mësimor në fuqi, si dhe njohjes dhe shlyerjes së lëndëve me ekuivalencë. Studimet në






	<p>FSHNSHH mund të ndiqen nga shtetas shqiptarë, shqiptarët etnikë jashtë kufijve shtetërorë si dhe nga çdo shtetas i huaj i cili ka njohuri të gjuhës shqipe</p> <p>Dokumenti nr. 3, Shtojca 1.2 Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore dhe Kërkimore e UNIKO</p>			
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentat e dorëzuar nga institucioni verën se Departamenti i Shkencave Sociale, në përputhje me Rregulloren e FSHNH, Statutin e Universitetit dhe ligjit të arsimit të lartë, propozon përpara çdo viti akademik numrin e studentëve për çdo program, në përputhje me kapacitetet akademike dhe infrastrukture të tij, sipas standardeve të cilësisë.</p> <p>GVJ bazuar në bisedat dhenë dokumentat e dorëzuar nga institucioni verën gjithashtu se Universiteti Fan S. Noli, në fillim të vitit akademik dhe në vijimësi, në bashkëpunim me stafin akademik të FSHNH dhe Qendrës së Karrierës përgatit dhe shpërndan materiale për publikun në lidhje me programet e studimit që ofron, zhvillon seanca të hapura me maturantët ku shpjegohen dhe orientohen një pjesë e elementeve që shoqërojnë veprimtarinë akademike.</p> <p>Dokumenti nr. 65, Shtojca 3.11 Praktika e Informimit të Studentëve me Programin e Studimit APS</p> <p>Dokumenti nr. 62 Shtojca 3.10 Praktika e Promovimit dhe Informimit të Maturantëve</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, rregullores së programit të studimit, faqes zyrtare të ëeb si dhe takimit me përfaqësues të tij, GVJ konkludon se nëpërmjet Sekretarisë mësimore, informohen studentët në mënyrë të detajuar për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve</p>



<p>studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>dhe ve në dispozicion të tyre, informacion dhe dokumentacion të posaçëm për kriteret e nevojshme për përparimin akademik në programin e studimit “Admnistrim dhe Politika Sociale”.</p> <p>Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për kohëzgjatjen e programit të studimeve si dhe mundësinë e transferimit të studimeve, instrumentat e realizimit të vlerësimit të njohurive për lëndë të ndryshme, komponentët përbërës të vlerësimit total të lëndës, organizimi i provimeve, realizimi i praktikave, përgatitja e punimit të diplomës, diplomimi, ndërpreja dhe rifillimi i studimeve, etj.</p> <p>Studentët informohen edhe nëpërmjet posterave që shpërndan IAL në shkollat në takimet me maurantët. Po ashtu në ditën e parë të fillimit të vitit akademik studentët realizojnë takim me drejtues të fakultetit si dhe pedagogë ku ata kanë mundësinë të njohin infrastrukturës, auditorët, të drejtat dhe përgjegjësië, programin e studimit dhe modulet përkatëse etj.</p> <p>Dokumenti nr. 3, Shtojca 1.2 Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore dhe Kërkimore e UNIKO Dokumenti nr. 65 Shtojca 3.11 Praktika e Informimit të Studentëve me Programin e Studimit APS</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, faqes zyrtare eeb të UNIKO si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se institucioni ndek procedurat në lidhje me transferimin e studimeve në përputhje dhe me bazën ligjore në fuqi (udhëzimi i MARS, nr. 17 datë 30.07.2019). Studentët informohen në lidhje me transferimin e studimeve, kur është e mundur, njohjen e kualifikimeve apo studimeve te pjesshme të realizuara në një institucion tjetër të arsimit të lartë. Gjithashtu mundësohet informacioni në lidhje me procesin e ekuivalentimit të studimeve, me universitetet e tjera jashtë vendit.</p> <p>Kriteret e transferimit të studimeve dhe ekuivalentimit sanksionohen qartë në rregulloren e UNIKO. Po ashtu institucioni ka vënë në dispozicion dhe tabelën e transferimeve të studentëve prej dhe nga programi i studimit.</p> <p>Dokumenti nr. 80 Shtojca 4.5.A urdhër I MASR mbi transferimet</p>

<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Nga vizita e GVJ në institucion si dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga UNIKO, GVJ konstaton se, përcaktimi i formës së vlerësimit të dijeve për lëndët specifike, bëhet nga pedagogu i lëndës si dhe pasqyrohet në silabusin e lëndës. Silabuset janë në dispozicion të studentëve në të gjitha format, si elektronikisht, përmes sistemit ESSE3, faqes së ëeb, ashtu edhe fizikisht në Departament përmes sekretarisë mësimore. Studentët pohojnë se njihen me format e vlerësimit të njohurive, nga komunikimi i drejtëpërdrejtë me pedagogët, qysh në fillim të procesit mësimor kur njihen me lëndën dhe në vazhdimësi.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Sipas Rregullores së programit të studimit, DSHS ka miratuar kriteret që duhen plotësuar për të shkuar drejtë provimit të formimit apo mbrojtjes se punimit të diplomës. Sipas rregullores, në muajin e parë të vitit të fundit të studimeve, sekretaria mësimore informon studentët rreth organizimit të provimit të formimit, si dhe seancave konsultuese rreth fondit të pyetjeve të mundshme të përfshira në provim. Shtojcën nr. 2.5.</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>GVJ, konkludon se, UNIKO dhe FSHNH ofron informacione në mënyrë periodike të organizuara në paraqitje të ndryshme, si gjatë tureve informuese në gjimnaze ashtu edhe gjatë vizitave në ambientet e Universitetet.</p> <p>Sekretaria Mesimore është ofruesi kryesor i informacionit për studentët e rinj dhe ata potencialë në të ardhmen. Gjimnazet janë target i synuar, dhe “Laboratori i Dijes” i krijuar nga studentët e Fakultetit, ishte një mënyrë shumë poromvuese për programet e studimit të FSHNH, sidomos përmes përfshirjes së gjimnazistëve në shkëmbimin e ideve me studnetët gjatë olimpiadës së këtij ‘laboratori’ të quajtur Rroke shkencën. http://www.unkorce.edu.al/sq/fakulteti-i-shkencave-natyrore-dhe-shkencave-humane</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>






Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p> <p>&</p> <p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, faqes zyrtare ëeb të UNIKO, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se nëpërmjet Sekretarisë mësimore, si dhe nëpërmjet rregullores që është e arritshme për këdo të interesuar në shumë forma të komunikimit, institucioni informon studentët në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit APS. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për kohëzgjatjen e programit të studimeve edhe nëpërmjet ëeb-it.</p> <p>Informacioni i nevojshëm publikohet në format letër, guida, rregullore dhe fletëpalosje, si dhe elektronikisht.</p> <p>Dokumenti nr. 37 Shtojca 2.5.C Rregullore e APS 2019-2020</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Pas kqyrjes së dokumentacionit të grupit të vetëvlerësimit, dhe gjatë takimeve të GVJ në institucion, u konstatuan përpjekje të vazhdueshme të UNIKO, për të studiuar tregun e punës dhe kërkesat e kriteret e tij.</p> <p>Fakulteti zhvillon vazhdimisht takime, aktivitete dhe orë të hapura me përfaqësues të instituconeve të cilat ofrojnë mundësi punësimi. Studentët shpesh janë pjesë e këtyre takimeve dhe informohen përmes qendrës së Karrierës dhe Alumnit pranë UNIKO, për mundësitë e reja ku ta mund të aplikojnë. Studentët shprehen se Panairi vjetor i punës, si bashkëpunim i UNIKO dhe Bashkisë Korçë, u vjen shumë në ndihmë, për identifikimin e varianteve të reja të punësimit sipas profilit të tyre të studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën,</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, faqes zyrtare ëeb të UNIKO dhe FSHNH, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se studentëve, nëpërmjet ëeb-it, sekretarisë mësimore dhe stafit akademik, në mënyrë të vazhdueshme u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, numrin e lëndëve për çdo</p>





infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	semestër, fillimin e mbarimin e semestrave, sezonin e provimeve, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Gjithashtu edhe biblioteka funksion dhe ofron kushte cilësore dhe një fond të mjaftueshëm botimesh hard copy dhe elektronikisht, shqip dhe anglisht kryesisht pa përjashtuar edhe gjuhët e tjera të mundshme të botimeve. Stafi IT së UNIKO, ndihmon studentët me informacion mbi mënyrat dhe oraret e përdorimit të Bibliotekës.			
Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	Nga takimi me studentët GVJ konstanton që materialet për lëndët që zhvillohen në këtë program studimi u mundësohen studentëve në të dy mënyrat; si fizikisht nga pedagogët e lëndës, ose ju dërgohen me email me adresat me domain e UNIKO. Edhe orientimi drejt fasiliteve që mundëson Biblioteka është i vazhdueshëm.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se UNIKO disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të regjistruar në programin e studimit për çdo vit akademik, si dhe për numrin e studentëve të punësuar pas diplomimit në IAL. Rregulloren e Sekretarisë Mësimore, Neni 16, në Shtojcën nr. 1.10
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë,	Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon nga ana e UNIKO bëhet kujdes për dokumentacionin që pasqyron çdo vit numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimit, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me

<p>tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit. Informacioni disponohet nga Sekretaria mësimore, i pasqyruar në Regjistrin Themeltar, që tregon regjistrimet, pezullimet apo dhe ndërprerjet e studimeve. Regjistri ruhet fizikisht dhe elektronikisht për një periudhë kohore të pacaktuar. Rregulloren e sekretarisë mësimore, në Shtojcën nr. 1.10.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se sekretaria mësimore ka përgjegjësinë dhe disponon në regjistrin përkatës të gjitha të dhënat e studentëve nga pranimi deri në diplomim.</p>			
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se institucioni përdor Sistemin ESSE3 , ku çdo student është i pajisur me username dhe passëord unik, duke i mundur kështu shërbimet e sekretarisë mësimore, pa frekuentuar ambientet fizike të Sekretarisë në Universitet. Kështu gjurmohen edhe studentët aktivë, gjatë ciklit normal të studimeve. Aksesi në hedhjen e të dhënave statistikore është i dedikuar vetëm për sekretarinë mesimore, dhe shfaq elementë të lartë mbrojtje nga ndërhyrjet.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion, u konstatua se DSHS, harton raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre. Informacioni transmetohet vit pas viti deri në diplomimin e studentëve dhe ruhet në Drejtorinë e Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor. http://172.16.0.2//sq/qka-statistika</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>



Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion GVJ konstatoi se, UNIKO ka parashikuar në organizimin dhe funksionimin e tij pjesëmarrjen e studentëve. Në Statutin e UNIKO është e përcaktuar që dy anëtarë të Senatit Akademik janë studentë. Studentët përfshihen edhe në procese të tjera vendimmarrëse, si dhe përfaqësohen në Komisionet për Sigurimin e Cilësisë dhe në Këshillin e Etikës.
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Në Statutin e IAL është e përcaktuar që një prej anëtarëve të NJSBC-së është anëtar i Këshillit Studentor. Po kështu, edhe në grupin e brendshëm të vlerësimit (GBV) ,në kuadër të procesit të akreditimit njeri prej anëtarëve është student. shtojcat 3.13.A. deri tek 3.13.D
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	Në dokumentacionin e dorëzuar nga GVB, arrijmë në konkluzionin se, FSHNH , ofron mundësinë e transferimit të studimeve. Transferimet pranohen në fillim të çdo vit akademik, jo më vonë se java e pestë e semestrit të parë. http://172.16.0.2/sites/default/files/regjistrimi2020.pdf Periudhat e studimit dhe detyrimet e programeve të studimit të shlyera në institucionet e tjera të arsimit të lartë, brenda dhe jashtë vendit, njihen dhe njehsohen, në një program të njejtë ose të ngjashëm studimi. Procesi i transferimit të studimeve është i rregullt dhe me proceduara të përcaktuara qartë në rregullore. Vendimin për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve e merr Komisioni i Ekuivalentimit të Njësisë Bazë.



<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion online GVJ konkludon siç u shprehem edhe më sipër, në UNIKO garantohej përfshirja e studentëve në procese të ndryshme vendimmarrëse apo të tjera, gjë që realizohet edhe në rastin e rishikimit për përmirësim të programit.</p>			
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion online GVJ konkludon se personeli akademik e ka në vëmendje barazinë dhe meritokracinë e studentit në vlerësim dhe në mënyrë hierarkike shqyrtohet çdo ankimim.</p> <p>Rregullorja e UNIKO Shtojcën nr. 1.2</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.6 Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe bisedës me institucionin GVJ konkludon se në Universitetin Fan S. Noli funksionon Qendra e Karrierës dhe Alumni (QKA), e cila është në shërbim të informimit të studentëve, por ajo që rekomandohet është që duhet fuqizuar dhe të jetë më gjithëpërfshirëse.</p> <p>Linku nr. 5.1. (http://172.16.0.2//sq/qkastatistika).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin,</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe bisedës me institucionin vihet re se veprimtaria e qendrës së Këshillimit të Karrierës orientohet drejt informimit të studentëve dhe këshillimit të tyre në momentin e rregjistrimit me çdo informacion në lidhje me</p>



<p>ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>programet e studimit të ofruara, avantazhet që secili prej tyre paartqet, mundësitë e punësimit në të ardhmen, etj Linku nr. 5.1. (http://172.16.0.2//sq/qkastatistika).</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në online qendra për Këshillimin e Karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p> <p>Detyrat dhe funksionimi i Qendres se Këshillimit të Karrierës në Universiteti Fan S. Noli është që ndërmjetësojë dhe të japë informacion në lidhje me bursa, trajnime, shkëmbime studentore.</p> <p>për studentët Universitetit Fan S. Noli, në linkun nr. 5.37. (https://korcajone.al/2019/05/14/trestudente-fitojne-bursa-studimi-per-ne-universitetin-e-korces/)</p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës online në institucion GVJ rekomandon se se Zyra për Këshillimin e Karrierës duhet të ndjek studentët pas diplomimit, të mbledhë dhe të përpunojë të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse.</p> <p>Këtë analizë e kishte bërë për disa programe e studimit në të cilat ka studentë të diplomuar.</p> <p>Gjatë bisedes në Institucion, GVJ-së në takimin me pedagogët që japin mësim në këtë program studimi, si dhe me studentët e këtij program studimi u bë me dije se nje pjese e studentëve të vitit të trete tashmë ishin angazhuar në internshipe</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p> <p>X</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>
----------------------------------------------------------------	------------------------------	-------------------------------------	------------------------------------	----------------------------------------------



VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	GVJ Konfirmon se UNIKO, disponon strukturën dhe procedurat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015, Neni103, Pika 1. Në manualin e Cilësisë UNIKO përcaktohen korniza e sigurimit të cilësisë, bordi i administrimit dhe njësitë përkatëse.(Dokumenti nr.20 Shtojca 1.16 Manuali i Cilësisë UNIKO)
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. GVJ,	GVJ, gjatë vizitës në institucion, konstatoi se Sistemi i Brendshëm i Cilësisë, funksionon si një rrjet i mirëorganizuar dhe shtrin funksionin e tij në të gjitha njesitë organizative të UNIKO. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Ka si përfaqësues një koordinator nga secila njësi kryesore e UNIKO dhe përfaqësues nga studentët. (Dokumenti nr.55 Shtojca 3.4 Lista e NJSBC)
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	Nga Shqyrtimi i dosjes së dorëzuar të GVB, Konstatuam se grupi ynë i akreditimit për programin Administrim dhe Politika Sociale, është duke kryer procesin e parë të vlerësimit të jashtëm të cilësisë. Për sa u përket akreditimeve të mëparshme në programe të tjera të UNIKO apo akreditimit institucional për vetë UNIKO, raportet e gjeneruar nga Vlerësim i Jashtëm i Cilësisë, shërbejnë si nxitës për përmirësime të vazhdueshme. Raporti vjetor i NJSBC në FSHNH për vitin 2017-2018 Shtojcën nr. 3.7.
Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni, vërejtëm se, UNIKO ka hartuar një plan strategjik 4 vjeçar, ku detajohen


<p>ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>politikat dhe praktikat që ndjek institucioni. Sikurse çdo Departament edhe DHS, ka hartuar një plan strategjik për programin e APS, në bazë të të cilit është ngritur edhe grupi mësimor që do të ndihmojë në përmirësimin e cilësisë së programeve të mbuluara.</p> <p>Aspekti më i veçantë i vetëvlerësimit që realizon UNIKO dhe DSHS, është edhe rishikimi periodik i kurrikulës, në mënyrë që ti përshtatet ndryshimeve të vazhdueshme të tregut të punës.</p> <p>Procedura e ndryshimeve në kurrikulën e programit të studimit APS në vitet 2017 & 2018</p> <p>Shtojcën nr. 2.12</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VI.2 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Drejtoria e Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor pranë UNIKO, është njësia përgjegjëse për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë në përputhje me ligjin e Arsimit të Lartë. (Shtojca nr. 1.5.A)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Procedurat e rishikimit periodik të programeve të studimit, janë të pasqyruara në Manualin e Cilësisë së UNIKO (Shtojca nr. 1.16). Në fund të çdo viti akademik, është Departamenti ai që harton propozimet e mundshme për ndryshime nisur nga ecuria e programit të studimit gjatë vitit. Më pas mbledhet Komisioni për të kryer rishikimin e programit apo edhe rregullores. Pra procedura është e formalizuar dhe transparente.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe</p>	<p>Raporti vjetor i veprimtarisë institucionale, ku përmbledhen analizat e procesit mësimor dhe kërkimit shkencor, prezantohet para stafit akademik të UNIKO dhe miratohet në mbledhjen me</p>






mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	pjesëmarrjen e Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit. Vendimi dhe raporti i miratuar i analizës vjetore i përcillët MASR. Shtojcat 3.13.A. deri tek 3.13.D			
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Të gjitha të dhënat e grumbulluara dhe shfrytëzuara për ndryshimet në funksion të rritjes të cilësisë, ruhen pranë departamentit dhe në arkivë. Raporti hartohet dhe shqyrtohet në të gjitha instancat deri në Senatin akademik ku edhe miratohet.			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	Analiza ose raporti i vlerësimit bën një reflektim të krahasimit mes rezultateve të arritura dhe atyre të pritshme, si dhe sugjeron për veprimet që duhet të ndërmerren për përmirësime. Shtojca nr. 3.30			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	GVJ nga takimi me përfaqësues të institucionit konkludon se në mënyrë periodike institucioni është kujdesur për vlerësimin e brendshëm si në nivel fakulteti ashtu dhe departamenti duke hartuar raport përkatëse të veprimtarisë. Ky raport shërben si dokument bazë për vetëvlerësimin e programeve të studimit. Gjithashtu raportet e vlerësimit të brendshëm ishin pjesë e dokumentacionit të shfrytëzuar gjatë procesit të akreditimit institucional. Shtojca nr. 1.16






<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Sipas takimit me përfaqësues të insitucionit metodat e përdorura përfshijnë instrumenta për mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies, cilësinë e literaturës, proceset didaktike të përdorura dhe konferencat e realizuara.</p> <p>Për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, realizon pyetësorë, ku Studentët japin mendimin e tyre në lidhje me zhvillimin e komponentëve të modulit, përgatitjen e pedagogut, sjelljen etij, etj.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Studentët shprehin mendimin e tyre në sondazhe, intervista të Ndryshme të realizuara nga Qendra e Karrierës dhe Alumni, apo nga punë dhënës të ndryshëm.</p> <p>DSHS ka përcaktuar një fushë të kërkimit shkencor, si Didaktika e shkencave, dhe në këtë kuadër ka realizuar dy konferenca shkencore ndërkombëtare, disa sesione shkencore, si dhe ka iniciuar studentë të programeve të studimit Master për të realizuar temat e diplomave në këtë fushë.</p> <p>DSHS për programin e studimit APS, mbështetur në rregulloren e saj, organizon në fund të çdo vit akademik rishikimin periodik të programit të studimit dhe rregullores mësimore të tij. Gjatë këtij rishikimi vëmendje i kushtohet elementëve përbërës të moduleve, organizimit të krediteve, literaturës së përdorur, procedurës së kontrollit të dijeve, dhe bazës së nevojshme didaktike.299 Në rishikimin e programit merren parasysh mendimet e pedagogëve dhe çështjet e evidentuara nga anketimi periodik i studentëve.</p> <p>Shtojca nr. 1.16.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik,</p>	<p>GVJ konstaton nga dokumentat e vëna në dispozicion dhe takimi me përfaqësues të tij se ka zhvilluar pyetësor anketues me studentë me qëllim përmirësimin e procesit të vlerësimit të studentëve në programe specifike.</p> <p>Dokumenti nr.69 Shtojca 3.13.B Konkluzione të anektimit të studentëve në FSHNH 2016</p> <p>Gjatë vitit akademik 2013-2014 është zhvilluar anketimi i studentëve në dy ciklet e studimit: bachelor dhe master.</p>






ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	Gjatë anketimit morën pjesë 320 studentë të FSHNH-së, nga të cilët 97 studentë në programet e studimit të DSHS. Studentët dhanë opinionet e tyre për pedagogët e angazhuar në programet e studimit që ata ndjekin.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Në manualin e Cilësisë të UNIKO, përcaktohet roli i strukturave akademike dhe administrative si dhe roli i Senatit Akademik lidhur me sigurimin e Cilësisë. Kjo bazë ligjore, garanton përfshirjen e aktorëve të brendshëm (stafi akademik, ndihmës e studentet) pa dallime e diskriminime dhe në respekt të integritetit akademik. (Shtojcat 1.2;1.5; 1.16)
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Studentët përfshihen në vlerësim përmes anketimit, dhe forumeve të debatit. Përfshihen edhe në vendimmarrje përmes përfaqësisë së tyre në Senatin Akademik, si pjesë e Qeverisjes së UNIKO, përfaqësisë në Komisionin e Etikës, Këshillit studentor, si dhe përfaqësisë në NJSBC.

<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe bisedave të zhvilluara, mund të pohojmë një gjithëpërfshirje në procesin e veprimtarisë së NJSBC të pedagogëve, stafit Administrativ, të cilët organizohen në mbledhje të vazhdueshme të Departamentit si hallka e parë e shprehjes së nevojave për përmirësime apo ndryshime në programet e studimit.</p>			
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve</p>	<p>Fakulteti është i angazhuar në respektimin e integritetit akademik dhe në shmangien e çdo diskriminimi apo pabarazie të gjithë plëve të përfshira në këtë proces. Procesi i vlerësimit zhvillohet duke respektuar Kodin e Etikës dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit akademik dhe studentëve. Për të siguruar përfshirjen e plotë të stafit në përmirësimin e cilësisë së programit, DBK ka krijuar grupet e punës që sigurojnë këtë të fundit në drejtim të kurrikulës, veprimtarisë shkencore dhe vëmendjes ndaj studentëve.</p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Përveç vlerësimit të brendshëm, element tjetër i sigurimit të cilësisë është dhe vlerësimi i jashtëm i cili koordinohet nga ASCAL. Ky vlerësim kryhet nëpërmjet hartimit të raporteve të vlerësimit, ku pasqyrohet gjendja aktuale dhe jepen rekomandime me qëllim përmirësim të përbushjes së standardeve të cilësisë.</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi VI.5



Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Çdo informacion në lidhje me politikat dhe praktikrat që lidhen me sigurimin e Cilësisë në UNIKO është i aksesueshëm nga i gjithë stafi akademik, ndihmës-akademik dhe studentët. Institucioni aprovon Planin e punës për drejtorinë e kurrikulave, sigurimit të cilësisë dhe kërkimit shkencor për vitin akademik ku përcaktohen hapat konkretë të veprimit. ¹ Dokumenti nr. Shtojca 1.5.1 Plani I Punës së drejtorisë së kurrikulave, sigurimit të cilësisë dhe kërkimit shkencor
Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Nga kontakti me përfaqësues të institucionit dhe shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar prej tyre konstatohet se institucioni ka respektin lirinë dhe etikën akademike dhe po ashtu të dhënat personale. Kanë miratuar rregullore për ruajtjen e të dhënave ku përcaktohet detyrimi për mbrojtjen e të dhënave. Në faqen e publikohet të gjitha politikat dhe praktikrat e sigurimit të cilësisë të cilat janë të aksesueshme për të gjithë. Dokumenti nr.13 Shtojca 1.9 Rregullore e ruajtjes së të dhënave
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Nisur nga analiza e raporteve të vlerësimit, Stafet angazhohen në plotësimin e rekomandimeve, ndjekjen e udhëzimeve për veprimet e marra. Masat, që synojnë përmirësimin e elementëve të evidentuara për rishikim, dokumentohen në formën e planeve të masave me qëllim Përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë. Në zbatim të rekomandimeve angazhohet stafi akademik dhe ai ndihmës akademik.
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të	GVJ konkludon në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga institucioni se ai vlerëson dhe përpiqet për efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive për monitorimin e cilësisë me qëllim përmirësimin e programit të studimit. Konkretisht cdo vit realizohet analiza e punës mësimore e cila shoqërohet me nxjerrjen e rekomandimeve për përmirësim në të ardhmen. Bazuar në

1 Dokumenti nr. Shtojca 1.5.1 Plani I Punës së drejtorisë së kurrikulave, sigurimit të cilësisë dhe kërkimit shkencor

cilësisë së programit të studimit.	Manualin e Cilësisë, Institucini ka ngritur Rrjetin e Cilësisë i cili ka detyrë të evidentojë problemet, të sigurojë ndjekjen e tyre, bazën e të dhënave, vlerësimin periodik, realizimin e studimeve për të vlerësuar ecurinë etyre, etj.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Mbledhjet e Asamblesë Akademike si dhe mbledhjet e Departamentit, përbëjnë dhe mënyrat më të shpeshta të informimit mbi arritjet dhe problematikave; në këto mbledhje bëhet identifikimi i nevojave për ndërhyrje për përmirësim.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X



Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor
“Administrim dhe Politika Sociale” të Institucionit të Arsimit të Lartë
“Universiteti Fan S. Noli”, Korçë

Pika të forta dhe afirmime:

1. UNIKO ofron programin e studimit Bachelor në Administrim dhe Politika Sociale në përputhje me misionin dhe fushën e veprimtarisë së tij dhe në përgjigje të nevojave të zhvillimit social- ekonomik lokal dhe/rajonial.
2. Program Bachelor në “Administrim dhe Politika Sociale” synon t’i përgjigjet nevojave lokale dhe rajonale për profesionistë të shkencave sociale.
3. Kurrikula strukturohet konform legjislacionit në fuqi dhe si program mësimor dhe programet e lëndëve respektojnë formatet e kërkuara.
4. Për realizimin e praktikave profesionale në vitin e tretë, Departamenti i Shkencave Sociale bashkëpunon me gati 20 institucione publike dhe OSHC ne rajonin e Korçës (Shtojca 3.5), të cilat kanë krijuar mundësi edhe për punësimin e të diplomuarve nga ky program.
5. Mjediset janë të pajisura me logjistikën e duhur për realizimin e programit të studimit.
6. Studentët janë pjesëmarrës në të gjitha hallkat e procesit të realizimit të programit të studimit, që nga vlerësimet për përmirësimin e syllabusesev, të programit, të vlerësimit për stafin akademik dhe pjesëmarrjes në projektet kërkimore dhe mobilitetin.

Pika të dobëta:


1. Programi i studimit Bachelor në “Administrim dhe Politika Sociale” ofrohet nga Departamenti i Shkencave Sociale, i cili ndodhet në Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane që nuk i takojnë të njëjtës fushë studimi sipas klasifikimit ISCED.
2. Lëndët ndërdisiplinore/integruese (C) kanë një përqindje më të lartë se 12-15% e krediteve dhe kjo nuk lidhet me shumllojshmërinë dhe mundësitë e lëndëve me zgjedhje, të cilat janë vetëm dy. Lëndët me zgjedhje nuk përcaktohen qartë.



3. Biblioteka nuk disponon literaturë fizike të nevojshme në mbështetje të këtij programi studimi si: tekste mësimore bazë në gjuhën shqipe; tekste mësimore dhe materiale ndihmëse në gjuhë të huaj.

Rekomandime:

1. Riorganizimi i strukturës organizative të Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane sipas fushave të studimit të referuara klasifikimit ndërkombëtar ISCED. Vendosija e Departamentit të Shkencave Sociale pranë një Fakulteti të Shkencave Sociale me degët e Ekonomisë, Politika Sociale dhe Sociologji e cila duhet ndarë nga Filozofia.
2. Sistemimi i lëndëve mbi administrimin e shërbimeve sociale (ka dy lëndë me të njëjtin emërtim). Lënda politikat e mbrojtjes sociale njëherë tjetër e quajtuar politika të mirëqenies sociale, që janë e njëjta gjë në përmbajtjen e termit mbrojtje sociale e mirëqenie sociale.
3. Lënda e Metodave të kërkimit të klasifikohet në lëndët bazë (A) të cilat specifikohen – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme. Kjo lëndë mund të ndërthuret me lëndën e logjikës që zhvillohet në vitin e parë, të cilat do t’i pajisin studentët me njohuri dhe aftësi për të kryer detyrat dhe projektet që do të zhvillojnë në lëndët e ndryshme përgjatë tre viteve dhe të aftësohen për punimin final të diplomës për studentët e shkëlqyer, që kanë arritur mesataren mbi 8.5 sipas kriterit të DSHS.
4. Biblioteka ka nevojë për më shumë libra, sidomos tekste të literaturës së detyrueshme që përdoren për lëndet karakterizuese të programit Bachelor në “Administrim dhe Politika Sociale”, të përcaktuara në syllabuset e lëndëve. Veçanërisht për lëndë kryesore ku tekstet universitare janë të botuara pas 2013 që është hapur ky program studimi. Orari i Bibliotekës nga dita e hënë deri ditën e premte, në orët 08:00 - 16:00 ka nevojë të rishikohet, sepse ajo nuk mund të funksionojë si administrata, por aksesit aty të jetë sipas nevojave të studentëve dhe stafit akademik.





SWOT ANALYSIS

Strengths:

1. UNIKO offers the Bachelor study program in "Administration and Social Policy" in accordance with the mission and field of its activity.
2. Bachelor program in "Administration and Social Policy" aims to respond to local and regional needs for social science professionals.
3. The curriculum is structured in accordance with the legislation in force and both the curriculum and the subject programs respect the required formats.
4. For the realization of professional internships in the third year, the Department of Social Sciences cooperates with almost 20 public institutions and CSOs in the region of Korça (Annex 3.5), which have created opportunities even for employment of graduates from this program.
5. The UNIKO facilities are equipped with the necessary logistics for the realization of the study program.
6. Students are participants in all stages of the process of realization of the study program, from evaluations for the improvement of syllabuses, the program, evaluation for academic staff and participation in research projects and mobility.

Weaknesses:



1. The Bachelor study program in "Administration and Social Policy" is offered by the Department of Social Sciences, which is placed in the Faculty of Natural Sciences and Humanities that do not belong to the same field of study according to the ISCED classification.
2. Interdisciplinary / integration courses (C) have a higher percentage than 12-15% of ECTS and this is not related to the variety and possibilities of elective courses, which are only two. Electives are not clearly defined.



3. The UNIKO library does not have the necessary physical literature in support of this study program such as: basic textbooks in the Albanian language; textbooks and supporting materials in foreign languages.

Recommendations:

1. Reorganization of the organizational structure of the main and basic units, include the Department of Social Sciences of the Faculty of Natural Sciences and Humanities according to the fields of study referred to the international classification ISCED. More concretely, establishment of the Department of Social Sciences at a Faculty of Social Sciences with branches of Economics, Social Policy and Sociology, which should be separated from Philosophy.
2. Revision of the subjects on the administration of social services (there are two courses with the same name). The subject of social protection policies is once again called social welfare policies, which are the same in the content of the term social protection and social welfare.
3. The subject of Research Methods should be classified in the basic subjects (A) which are specified - methodological preparation and general culture. This course can be combined with the course of Logics that is developed in the first year of studies, which will equip students with knowledge and skills to perform tasks and projects that will develop in different courses over three years of studies and to gain the proper skills for the final diploma for excellent students, who have achieved an average above 8.5 according to the Department of Social Sciences' criterion.
4. The library needs to be equipped with more textbooks, especially those defined in the compulsory literature of syllabuses, especially texts used for the characteristic subjects of the Bachelor program in "Administration and Social Policy", defined in the syllabi of the subjects. Especially for the main subjects of this program where university textbooks are published after 2013 when this study program was opened. The library schedule from Monday to Friday, from 08:00 to 16:00 needs to be reviewed, because it can not function as an administration, but access to the Library should be according to the needs of students and of academic staff.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

